



Agjencia Kadastrale e Kosovës
Kosovska Katastarska Agencija
Kosovo Cadastral Agency

RAPORTI VJETOR 2021

Prishtinë, 2022

Contents

1. SHKURTESAT	5
2. FJALA HYRËSE	6
3. MANDATI DHE PËRGJEGJËSITË	9
4. STRUKTURA ORGANIZATIVE	10
5. BUXHETI	12
5.1 REALIZIMI I BUXHETIT	13
5.1 TË HYRAT	14
5.2 PROKURIMI PUBLIK	15
5.3 PRODUKTET E FATURUAR PËR SHËRBIMET ONLINE	17
5.4 AUDITIMI	18
5.5 AKTIVITETET TJERA BUXHETORE	19
6. KORNIZA LIGJORE	21
6.1 PROJEKTLIGJI PËR KADASTËR TË PRONËS SË PALUAJTSHME	21
6.2 PROJEKTLIGJI PËR KRIJIMIN E INFORMACIONIT HAPËSINOR	
NË REPUBLIKËN E KOSOVËS	23
6.3 PLOTËSIM NDRYSHIMI I UDHËZIMEVE ADMINISTRATIVE	
NGA FUSHA E KADASTRIT	27
7. SISTEMI I INFORMACIONEVE KADASTRALE PËR TOKËN NË KOSOVË	31
7.1 KORRIGJIMI I TË DHËNAVE	35
7.2 SISTEMI I INFORMACIONEVE KADASTRALE PËR TOKËN NË KOSOVË - HARTA KADASTRALE	35
7.3 MIGRIMI I TË DHËNAVE NË SIKTK-HARTA KADASTRALE	36
8. LICENCIMI I GJEODETËVE DHE KOMPANIVE GJEODETE	38
9. MONITORIMI I ZYRAVE KADASTRALE KOMUNALE, KOMPANIVE TË LICENCUARA GJEODETE DHE GJEODETËVE TË LICENUAR	42
10. SHPRONËSIMI	44
11. KOMASACIONI	46
12. LEGALIZIMI	47
13. INFRASTRUKTURA KOMBËTARE E INFORMACIONEVE HAPËSINORE	49
14. SISTEMI I UNIFIKUAR I ADRESAVE	53

15. ZHVILLIMI I KAPACITETEVE PËR PËRGJITHËSIMIN E HARTAVE DIGJITALE TOPOGRAFIKE	56
15.1 PËRGJITHËSIMI I HARTËS TOPOGRAFIKE 1:250 000	58
15.2 KRIJIMI, REDUKIMI DHE POZICIONIMI I SIMBOLEVE	59
15.3 HARTA TOPOGRAFIKE 1:250 000	60
15.4 REKOMANDIMET DHE PËRMBYLLJA E PROJEKTIT	60
16. HARTA E PRONËSISË	63
16.1 METODOLOGJIA, ANALIZIMI I TË DHËNAVE GRAFIKE DHE FILTRIMI I TË DHËNAVE NË PROCESIN TOPOLOGJIK	65
17. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONE PUBLIKE DHE SHKËMBIMI I TË DHËNAVE ME INSTITUCIONET E JASHTME	69
18. SKËMBIMI I TË DHËNAVE ME INSTITUCIONET E JASHTME	71
18.1 SHËRBIMET E OFRUARA ZYRAT KADASTRALE KMUNALE DHE AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS	72
19. KOORDINIMI I PROJEKTEVE, BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR	74
19.1 PROJEKTI PËR REGJISTRIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME DHE INFRASTRUKTURËS GJEOPHËSINORE (REGIP)	74
19.2 PROJEKTI PËRKRAHËS I QEVERISË NORVEGJEZE	80
19.3 PROJEKTI SPATIAL II I PËRKRAHUR NGA QEVERIA HOLANDEZE	82
19.4 PROJEKTI PËRKRAHËS I QEVERISË JAPONEZE	83
19.5 PJESËMARRJA E AKK-SË NË KONFERENCËN E EUROGEOGRAPHICS	85
20. PËRKRAHJE PROFESIONALE, LIGJORE DHE TEKNIKE	86
21. ADMINISTRIMI INFRASTRUKTURËS SË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT (TI)	88
22. GJITHPËRFSHIRJA SHOQËRORE	98
22.1 GRUAJA DHE PRONA	98
22.2 KOMUNITETET DHE QASJA E TYRE NË PRONË	100

TABELAT

TABELA 1.STRUKTURA ORGANIZATIVE

TABELA 2.PASQYRA E BUXHETIT, NDARJA SIPAS KATEGORIVE, FONDI BURIMOR 10

TOTALI 3. PASQYRA E BUXHETIT DHE SHPENZIMEVE SIPAS KATEGORIVE- NDARJA FILESTARE, FONDI BURIMOR 10.

TABELA 4. PASQYRA E BUXHETIT DHE SHPENZIMEVE SIPAS KATEGORIVE- NDARJA FINALE, FONDI BURIMOR 10.

TABELA 5.PASQYRA E BUXHETIT DHE SHPENZIMEVE SIPAS KATEGORIVE, FONDI BURIMOR 04-06, HUAMARRJA.

TABELA 6.PASQYRA E TË HYRAVE SIPAS KOSTOS

TABELA 7.AKTIVITETET E PROKURIMIT

TABELA 8. NUMRI I NJËSIVE TË PËRPUNUARA NGA OE DHE APROVUARA NGA AKK

TABELA 9. NUMRI I KËRKESAVE, LICENCAVE TË APROVUARA DHE NUMRI I PËRG-JITHSHËM TË LICENCAVE

TABELA 10. RRITJA E NUMRIT TË PËRDORUESVE TË GJEOPORTALIT SHTETËROR NDËR VITE

TABELA 11. SHTRESAT E AZHURNUAR NË GJEOPORTALIN SHTETËROR GJATË VITIT 2021

TABELA 12. SIPËRFAQJA NË METRA KATROR E SHTRESAVE TË LLOJEVE TË PRONËS

TABELA 13. STATISTIKA RRETH KËRKESAVE TË PËARASHTRUARA NGA INSTITUCI-ONE PUBLIKE

TABELA 14. NDRYSHIMET E VLERAVE HADRVERIKE TË SHFRYTËZUARA GJATË VITIT 2021

TABELA 15. KRAHASIMI I PARCELAVE NË SIKTK-T DHE SIKTK-HK

TABELA 16. NUMRI I GRAVE DHE PARCELAVE QË KANË FITUAR TË DREJTËN “PRO-NESI / POSEDIM I PËRBASHKËT”

1. SHKURTESAT

AKK - AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS

SIRA - SISTEMI I INFORMACIONEVE PËR REGJISTRIN E ADRESAVE

IKIH- INFRASTRUKTURA KOMBËTARE E INFORMACIONEVE HAPËSINORE

INSPIRE - DREKTIVA E BASHKIMIT EVROPIAN 2007/2 MBI IKIH

KOPOS – SITEMI I POZICIONIMIT SATELITORË NË KOSOVË

KRPP - KOMISIONI RREGULLATIV I PROKURIMIT PUBLIK

LMFPP - LIGJI PËR MENAXHIMIN E FINANCIVE PUBLIKE DHE PËRGJEGJËSIVE

MEA - MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT

MMPH – MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

MMPHI – MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS

MINT - MINISTRIA E INDUSTRISË, NDËRMARRËSISË DHE TREGËTISË

MFPT - MINISTRIA E FINANCIVE, PUNËS DHE TRANSFEREVE

MEF - MINISTRIA E EKONOMISË DHE FINANCIVE

REGIP – PROJEKTI PËR REGJISTRIMIN E PRONËS DHE INFRASTRUKTURË GJEO-HAPËSINORE

RIK - RINDËRTIMI I INFORMACIONEVE KADASTRALE

SIKTK– SISTEMI I INFORMACIONEVE KADASTRALE PËR TOKËN NË KOSOVË

SIKTK-HK – SISTEMI I INFORMACIONEVE KADASTRALE PËR TOKËN NË

KOSOVË-HARTA KADASTRALE

SIKTK–T SISTEMI I INFORMACIONEVE KADASTRALE PËR TOKËN NË KOSOVË-TEKSTUALE

SOA – ARKITEKTURË E ORIENTUAR NË SHËRBIME, ANG. SERVICES ORIENTED ARCHITECTURE

OE – OPERATORI EKONOMIK

ZKK - ZYRA KADASTRALE KOMUNALE

ZKA - ZYRTARI KRYESOR ADMINISTRATIV

2. FJALA HYRËSE

Ngjashëm me dy vitet paraprake edhe gjatë vitit 2021 institucionet publike në Republikën e Kosovës janë ballafaquar me sfidat e shkaktuara nga pandemia COVID 19. Kjo situatë e funksionimit nën pandemi dhe me masa të veçanta për parandalim të përhapjes së pandemisë, bashkë me ndryshimet që ndodhën në Qeverinë e Republikës së Kosovës edhe për Agjencinë Kadastrale të Kosovës imponuan një pezullim të përkohshëm në implementimin e projekteve kapitale. Për këtë periudhë Agjencia ishte e fokusuar kryesisht në ofrimin e shërbimeve esenciale për qytetarët dhe institucionet e Republikës së Kosovës, të parëve për tua siguruar të drejtat pronësore e për tua mundësuar shfrytëzimin e benefiteve nga prona e regjistruar në kadashtër dhe të dytëve për tua lehtësuar implementimin e mandateve të tyre në fushat që lidhen me të dhëna kadastrale dhe gjeohapësinore. Po ashtu, viti 2021 kishte sfida tjera. Një ndër kryesoret me të cilat është ballafaquar Agjencia Kadastrale e Kosovës gjatë vitit 2021 ishte paqartësia që rrjedh nga organizimi i brendshëm dhe nga rregullorja për sistematizimin e vendeve të punës si dhe nevoja për ngritjen e kapaciteteve profesionale, kjo për shkak se portfoli, mandati dhe përgjegjësitë e Agjencisë janë në ngritje konstante ndërsa personeli për numri është i pandryshueshëm. Ngritja e kualitetit të të dhënave kadastrale duke përfshirë këtu edhe ato që gjenerohen nga institucione tjera e të cilat regjistrohen në kadashtër - komasacioni, shpronësimi, legalizimi janë po ashtu një sfidë me të cilën Agjencia u ballafaqua gjatë vitit 2021 e me të cilën do të merret gjatë vitin 2022. Funksionalizimi i Zyrrave Kadastrale Komunale në tre komunat në veri, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveqan është sfidues. Të gjitha shërbimet kadastrale banorët e këtyre Komunave i marrin në Agjenci edhe pse janë trajnuar zyrtarët për këto zyra kadastrale, të cilat fatkeqësisht ende mbeten jofunksionale. Avancimi në ofrimin e shërbimeve dhe pagesave online, respektivisht mungesa e nënshkrimit digjital,

vulës digjitale pritet të marrë përgjigje gjatë vitit 2022. Paqartësi ka edhe në lidhje me publikimin apo mos publikimin e emrave të pronarëve të paluajtshmërive - a mund apo jo të publikohen të dhënat personale duke marr parasysh Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale do të jetë një temë tjetër e interesit për trajtim gjatë vitit 2022. Ofrimi i të dhënave të AKK-së për institucione publike, të cilat aktualisht bëhen me pagesë e të cilat i shtojnë procedurat e panevojshme burokratike, kur dihet se të hyrat nga këto shërbim derdhen në të njëjtin buxhet ishte sfidë jo vetëm për AKK por edhe për institucione tjera publike të interesit. Sfida shtesë e Projektit REGIP ishte alokimi jo i mjaftueshëm i mjeteve buxhetore tek kategoria e mallrave dhe shërbimeve në pjesën e parë të vitit nga Ministria e Financave sipas kërkesave të projektit. Sidoqoftë, me përkrahjen politike, me angazhimin profesional të ekspertëve të AKK-së dhe me përkrahje të ekspertëve të jashtëm, sfidat e sipër përmendura pritet të jenë të tejkaluara. Por, edhe krahas kësaj, gjatë vitit 2021 Agjencia arriti të krijojë disa produkte kapitale me më të rëndësishmet mes tyre Hartën Topografike 1:250.000 dhe Hartën e Pronësisë si dhe të ndërmarrë disa aktivitete kapitale me theks të veçantë ndërlidhjen e sistemit të adresave me regjistrin civil. Nga ana tjetër, kjo periudhë rezultoi e suksesshme në fusha tjera e me theks kryesor në avancimin e kornizës ligjore dhe përgatitjen e termave të referencës dhe specifikacioneve teknike për projekte kapitale që pritet të implementohen në vitin 2022 dhe viteve në vijim. Konkretisht, janë finalizuar draftet e dy projekt ligjeve të rëndësishme, atë për kadastër dhe atë për infrastrukturë gjeohapësinore, janë azhurnuar e ndryshuar disa udhëzime administrative si dhe janë finalizuar specifikacionet teknike të projekteve kapitale si Aerofotografimi i territorit të Republikës së Kosovës, përfundimi i implementimit të Sistemit të Unifikuar të Adresave, Rindërtimi i Informacioneve Kadastrale, azhurnimi i strategjisë për infrastrukturën kombëtare të informacioneve hapësinore e të tjera. Gjatë këtij viti AKK zgjeroi dhe thelloi bashkëpunimin profesional me palë

të ndryshme të interesit, me më të rëndësishmet mes tyre Banka Botërore dhe JICA, Agjencia e Regjistrimit Civil, Departamenti për Tatim në Pronë, Instituti për Planifikim Hapësinor, Agjencia për Barazi Gjinore, Agjencia për Informim dhe Privatësi etj. Gjatë vitit 2021 u bashkëpunua ngushtë edhe me Kabinetin e Ministrit të MMPHI dhe me Zyrën e Kryeministrit. Si rezultat i këtyre bashkëpunimeve pritet shtimi i produkteve hartografike, shtimi i produkteve që po ofrohen “online” dhe shtimi i institucioneve të cilave iu mundësua pajisja me produkte dhe shërbime “online”. Rrjedhimisht, pritjet janë që viti 2022 të jetë viti i implementimit të projekteve kapitale nga të cilat do të përfitonin qytetarët pa dallim statuti shoqëror, gjinie e etnie, institucionet publike, bizneset etj.

3. MANDATI DHE PËRGJEGJËSITË

Agjencia Kadastrale e Kosovës është autoriteti qendror për mirëmbajtjen e bazës së të dhënave kadastrale, për mirëmbajtjen e regjistrave pronësorë, për hartografi dhe GIS, për sistemin e unifikuar të adresave, për infrastrukturën kombëtare të informacioneve hapësinore dhe për administrimin e Infrastrukturës së Teknologjisë së Informacioneve (TI) respektivisht qendrës së parë dhe të dytë të të dhënave. Si institucion i nivelit qendror, AKK ka kompetenca për nxjerrjen e udhëzuesve dhe kornizave të punës lidhur me të gjitha veprimtaritë kadastrale, është përgjegjëse për trajnimin dhe certifikimin e zyrtarëve në Zyrat Kadastrale Komunale për operim në Sistemin e Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovës (SIKTK) dhe për trajnimin, certifikimin dhe licencimin e gjeodetëve dhe kompanive gjeodete për ofrimin e shërbimeve kadastrale. Duke u bazuar në Ligjin për Kadastër, AKK ka deleguar te ZKK-të detyrat për regjistrimin dhe mirëmbajtjen e të dhënave në SIKTK. ZKK-të ofrojnë shërbime për persona fizik dhe juridik si dhe për institucionet publike në 35 nga 38 komunat e Republikës së Kosovës, ndërsa në tre Komuna, respektivisht në Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveqan edhe krahas përpjekjeve të AKK-së administrimi i kadastrës nuk po bëhet konform legjislacionit të Republikës së Kosovës. Si rezultat i kësaj dhe me qëllimin e ofrimit të shërbimeve kadastrale për qytetarët e këtyre tri komunave, AKK duke u bazuar në Ligjin për kadastër ka vendosur që të pranojë kërkesat e qytetarëve, dhe për të njëjtat të lëshohen dokumente kadastrale dhe pronësore si dhe të bëhet mirëmbajtja e Regjistrit të të Drejtave mbi Pronat të Paluajtshme. Të drejtat, përgjegjësitë dhe në përgjithësi mandati i AKK-së është i rregulluar me Ligjin për Kadastër dhe me akte të tjera nënligjore, të gjitha të qasshme përmes linkut <http://www.kca-ks.org/legjislacioni>.

4. STRUKTURA ORGANIZATIVE

Agjencia Kadastrale e Kosovës vepron në bazë të Rregullores me Nr. 20/2014 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në AKK e aprovuar me datë 08.12.2014. Bazuar në këtë rregullore AKK në strukturën e vet organizative ka gjithsej 5 Drejtori dhe 14 sektore. Numri i të punësuarve të aprovuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2021 është 52 punëtorë. Te aprovuar janë 52 dhe aktual janë 48, prej tyre 31 Meshkuj dhe 17 Femra. Mosha mesatare është 43 vjet. Në Agjencinë Kadastrale të Kosovës janë të punësuar edhe tetë (8) zyrtarë si staf mbështetës të cilët janë të financuar nga donatorët, prej tyre 6 meshkuj dhe 2 femra. Roli i tyre në AKK është shumë i rëndësishëm ata japin përkrahje në zhvillimin e projekteve të AKK-së. Me datë 02.06.2021 z. Avni Ahmeti jep dorëheqje nga pozita e Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë Kadastrale të Kosovës. Ministrit i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës Z. Liburn Aliu me vendim nr. 2111 të dt. 03.06.2021 aprovon dorëheqjen. Nga data 03.06.2021, me Vendimin Nr. 2131/21 të Ministrit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës Z. Liburn Aliu, emëron znj. Afërdita Thaçi në pozitën Zëvendësueses së Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kadastrale të Kosovës. Z-nja Afërdita Thaçi do të ushtrojë përgjegjësitë e saja komfor Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura si dhe legjislacionit tjetër përkatës në fuqi.

Kategoria funksionale	Numri i nëpunësve civil në fillim të vitit 2021	Vendet e lira pune dhe të planifikuara për rekrutim në fillim të vitit 2021	Numri i nëpunësve civil të larguar nga SHC në vitin 2021	Vendet e plotësuara gjatë vitit 2021	Numri i nëpunësve civil në fund të vitit 2021
Nivel i lartë drejtues	1	0	0	0	1
Niveli drejtues	12	2	2	0	12
Niveli profesional	29	0	1	0	26
Nivel tekniko-administrativ	9	0	0	0	9
Gjithsej	51	2	1	0	48

Tabela 1. Struktura organizative

5. BUXHETI, PROKURIMI DHE AUDITIMI

Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2021 është aprovuar me 06.01.2021 përmes ligjit Nr. 07/ I-041 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021. Rishikimi i buxhetit ka hyrë në fuqi me datën 06.08.2021 përmes ligjit Nr. 07/I-41 për ndryshimin dhe plotësimin mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021. Agjencia Kadastrale e Kosovës financohet nga dy burime financimi, respektivisht nga Granti i Qeverisë dhe nga Huamarrja e Bankës Botërore. Vlera fillestare e buxhetit të ndarë për vitin 2021 në total nga dy burimet e Financimit ka qenë 7,293,247.00 €, i kategorizuar në katër kategori si paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, shërbime komunal e dhe pasuri jo financiare.

Destinimi	Buxheti i planifikuar(€)	Buxheti i aprovuar(€)	Buxheti i rishikuar(€)
Pagat	402,122.12	295,747.00	295,747.00
Mallra dhe Shërbime	397,000.00	299,000.00	234,229.00
Shërbime Komunale	5,500.00	5,500.00	5,500.00
Pasuri jo Financiare	2,475,000.00	363,000.00	210,000.00
Totali:	3,279,622.12	963,247.00	745,476.00

Tabela 2.Pasqyra e buxhetit, ndarja sipas kategorive, Fondi burimor 10

5.1 REALIZIMI I BUXHETIT

Në vitin 2021 AKK ka shpenzuar 688 345.00 € në total apo rreth 61 përqind të ndarjes finale të buxhetit.

Destinimi	Buxheti / alokimi(€)	Shpenzimi(€)	Buxhet / Shpenzim (€) %
Pagat	295,747.00	352,001.00	119
Mallra dhe Shërbime	299,000.00	203,442.00	68
Shërbime Komunale	5,500.00	2,763.79	50
Pasuri jo Financiare	363,000.00	34,114.00	9
Totali:	963,247.00	592,320.26	61

Totali 3. Pasqyra e buxhetit dhe shpenzimeve sipas kategorive- ndarja filestare, Fondi burimor 10.

Ndarja finale:

Destinimi	Buxheti / alokimi(€)	Shpenzimi(€)	Buxhet/ Shpenzim(€) %
Pagat	352,000.53	352,001.00	100
Mallra dhe Shërbime	204,381.07	203,442.00	100
Shërbime Komunale	2,782.62	2,763.79	99
Pasuri jo Financiare	72,084.00	34,114.00	47
Totali:	631,248.22	592,320.26	94

Tabela 4. Pasqyra e buxhetit dhe shpenzimeve sipas kategorive- ndarja finale, Fondi burimor 10.

Destinimi	Buxheti / alokimi (€)	Shpenzimi(€)	Buxhet / Shpenzim(€) %
Mallra dhe Shërbime	200,000.00	96,025.06	48
Pasuri jo Financiare	6,130,000.00	0	0
Totali:	6,330,000.00	96,025.06	1.5

Tabela 5.Pasqyra e buxhetit dhe shpenzimeve sipas kategorive, Fondi burimor 04-06, Huamarrja.

Koment: Raporti është hartuar bazuar në raportin zyrtar nga Sistemi i Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësi (SIMFK).

5.1 TË HYRAT

AKK përmes sektorit të produkteve realizon të hyra për buxhetin e Republikës së Kosovës të cilat gjenerohen nga dy kategori, respektivisht kategoria e Licencave për Kompani dhe gjeodet të licencuar dhe kategoria e produkteve. Planifikimi i të hyrave për vitin 2021 ka qenë në vlerë prej 105,000.00€, ndërsa kjo vlerë për vitit 2021 ishte 128,816.00€.

Kodet	Janar-Mars	Prill-Qershor	Korrik-Shtator	Tetor-Dhjetor	Totali
50401	23,407.50 €	23,004.00 €	22,390.00 €	45,314.50 €	114,116.00€
50201	4,000.00 €	4,600.00 €	4,100.00 €	2,000.00 €	14,700.00 €
Totali	27,407.50 €	27,604.00 €	26,490.00 €	47,314.50 €	128,816.00€

Tabela 6.Pasqyra e të hyrave sipas kostos

5.2 PROKURIMI PUBLIK

AKK ka dorëzuar raportin vjetor mbi kontratat e nënshkruara publike për aktivitetet e prokurimit publik për vitin fiskal 2021 në Komisioni Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP). Ky raport është hartuar në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit për Prokurim Publik, duke paraqitur një analizë mjaft të detajuar mbi të gjitha aktivitetet e prokurimit publik të zhvilluara në AKK, sipas kontratave publike të nënshkruara gjatë vitit 2021. Agjencia Kadastrale e Kosovës brenda 15 ditëve pas shpalljes së miratimit të buxhetit për vitin fiskal 2021 ka përgatitur dhe dorëzuar në Agjencinë Qendrore të Prokurimit (AQP) Planifikimin Final të Prokurimit, duke u bazuar në kërkesat e njërive kërkuese të aprovuara nga personat përgjegjës për buxhet dhe nga Drejtori i Përgjithshëm. Planifikimi i prokurimit ka qenë konform buxhetit të AKK-së për vitin fiskal në fjalë. Agjencia Kadastrale e Kosovës bazuar në planifikimin final të prokurimit për vitin fiskal 2021 ka zhvilluar 5 aktivitete të prokurimit. Secili proces i prokurimit është administruar përmes këtyre hapave në vijim:

- Planifikimi i Prokurimit,
- Parashikimi i Vlerës dhe Klasifikimi i Kontratës, Përcaktimi i Procedurës së Prokurimit, Përgatitja e Dosjes së Tenderit,
- Publikimi, Hapja dhe Vlerësimi i Tenderëve, Dhënia dhe Nënshkrimi i Kontratës, Menaxhimi i Kontratës.

Duke u bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik të Kosovës, AKK ka paraqitur të gjitha kontratat e nënshkruara, duke përfshirë edhe ato me vlerë minimale. Raporti në vazhdim i pasqyron të gjitha aktivitetet e prokurimit publik të zhvilluara gjatë vitit 2021 në AKK.

PROKURIMI

Nr	Përshkrimi i kontratës	Emri i OE të cilit i është dhënë kontrata	Vlera e kontratës	Data e lidhjes së kontratës
1.	Shtypja, botimi dhe shërbimet tjera.	G.I.Grafo - Loni SH.P.K., Halil Alidemaj, PR-ISHTINË,	4.937,00€	26.03.2021
2.	Zgjerimi i qendrës së të dhënave (HW+SW)	InterAdria L.L.C., ALI KELMENDI NR.28, PRISHTINË	13,711.00€	16.08.2021
3.	Zgjerimi i qendrës së të dhënave (HW+SW) - Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative	Botek shpk, Rr. Agim Ramadani, Objekti C, Prishtine	58,373.00€ (Pjesërisht e realizuar/Shkëputur)	15.09.2021
4.	Furnizim me pajisje shpenzuese të TI-së	NOA TRADING SHPK PRISHTINË	562.00€	12.03.2021
5.	Furnizim me BackUp Tape dhe mbajtëse për TV	EUROPRINTY, HEKU-RUDHËS, FUSHË KO-SOVË	960.00€	01.11.2021

Tabela 7. Aktivitetet e prokurimit

5.3 PRODUKTET E FATURUAR PËR SHËRBIMET ONLINE

Gjate vitit 2020 dhe 2021 Agjencia Kadastrale e Kosovës ka nënshkruar Memorandume bashkëpunimi me një numër të institucioneve vendore që kanë pasur interes për ueb shërbime. Memorandume bashkëpunimi për ueb shërbime janë bërë edhe me bankat dhe institucionet mikro-financiare si dhe me oden e përmbaruesve dhe me noterët. Në janar të vitit 2021 është filluar me faturimin e ueb shërbimeve. Faturimi është bërë në baza mujore. Me banka dhe me institucionet tjera financiare nuk ka pasur probleme rreth pagesës së faturave, ndërsa institucionet publike, disa prej tyre kanë hezituuar për ti paguar faturat për ueb shërbime, me arsyetimet se institucioni publik nuk duhet paguar institucionit publik, duke u mbështetur edhe në legjislacionet e institucioneve përkatëse të cilat parashohin në disa raste lirimin nga pagesa. Janë organizuar disa takime me Institucione dhe janë informuar për bazën ligjore ku AKK mbështet faturimin. Informimi është bërë edhe përmes shkresave zyrtare të cilave u është bashkëngjitur edhe interpretimi ligjor i Zyrës Ligjore në Ministrinë e Financave. Aktualisht shumica e Institucioneve kanë realizuar faturat - obligimet, përjashtimisht dy institucione.

SISTEMI I FATURIMIT

Sistemi i Faturimit është sistem i bazuar në ueb i cili bënë lëshimin e faturave tek palët (klientët) për pagesa, dhe ku gjithashtu bëhet regjistrimi i faturave të paguara/dorëzuara nga palët. Prej të njëjtit nxirren edhe raporte për pagesat dhe bëhen krahasime të vlerave në xhirollogari të AKK-së dhe faturave të regjistruara. Gjatë vitit 2021 janë lëshuar 1101 fatura të paguara.

5.4 AUDITIMI

Gjatë vitit 2021 Zyra kombëtare e auditorit (ZKA) ka kryer auditimin e pasqyrave financiare për vitin 2020 për Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit. Agjencia Kadastrale e Kosovës si pjesë e organizimit të kësaj Ministrie ka qenë pjesë e auditimit, ku sipas kërkesës së auditorëve janë ofruar mostra për auditimin nga të gjitha sektorët e DFSHP. Raporti i auditorit është hartuar për MEA duke e përfshirë edhe AKK-së si njësi buxhetore në kuadër të buxhetit të MMPH-së. Auditimi është fokusuar në Pasqyrat vjetore financiare, në Menaxhimin financiar dhe në kontrollin dhe zbatimin e rekomandimeve nga viti paraprak. Sipas vlerësimeve të auditorit, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2020 paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale. Nga të gjeturat e ZKA ku përfshihet edhe AKK është Mungesa e evidencave për vijueshmërinë në punë për zyrtaret e angazhuar sipas marrëveshjes Brukselit.

Konkretisht me Ligjin Nr.04/L-199 për ratifikimin e marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, Qeveria e Kosovës me vendim nr. 06/39 të datës 22.07.2015, MMPH pas një procesi të rekrutimit, me akt emërimi kishte integruar 38 nëpunës, për AKK- në 6 nëpunës, të komunitetit serb, ish pjesëtarë të “Mbrotjtjes Civile”. Këta punonjës ishin planifikuar të sistemohen nëpër komuna në pjesën veriore të Kosovës. Për arsye politike këta punëtor nuk janë të sistemuar dhe si pasojë nuk kemi evidencë për vijueshmërinë e tyre në punë. Po ashtu gjatë vitit 2021 Njësia e Auditimit të Brendshëm ka audituar Sektorin për buxhet dhe financa, Sektorin për burime njerëzore dhe Sektorin e logjistikës – menaxhimin e pasurisë. Nga NJAB kemi pranuar raport vetëm për menaxhimin e pasurisë, ku si e gjetur është vlerësuar mos ekzistimi i evidencave të sakta për stoqet-rezervat, si pasojë e mosfunksionimit të E-Pasurisë.

MONITORIMI NGA MFPT-NJËSIA QËNDRORE HARMONIZUESE

Njësia Qëndrore Harmonizuese për Menaxhimin e Financave dhe Kontrollit të Brendshëm bazuar në Ligjin Nr.06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, ka realizuar Monitorim për cilësinë e menaxhimit financiar dhe kontrollit në AKK. Rekomandime dhe të gjetura nuk ka pasur. Opinioni në lidhje me këtë monitorim është se AKK në përgjithësi ka kontrolle të duhura në raport me obligimet statusore të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli kanë dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

5.5 AKTIVITETET TJERA BUXHETORE

AKK ka dorëzuar Raporti Vjetor Financiar për vitin 2020 në MMPH. Raporti është përgatitur sipas standardeve ndër-kombëtare të kontabilitetit të sektorit publik, i cili raport i përmbush të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi. Pas aprovimit të buxheti për vitin 2021, bazuar në kërkesat e njësive kërkuese në AKK, kemi përgatitur planin e alokimit të mjeteve për vitin fiskal 2021, për të gjitha kategoritë ekonomike. Kërkesa është dërgua në MMPH-MF pas aprovimit nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA). Bazuar në LMFPF dhe procedurat e MFK-së, në bashkëpunim me Drejtoritë e AKK-së kemi përgatitur “Regjistrin e rrezikut”. Në këtë formular janë trajtuar: objektivat, masat, prioritetet, projektet, përshkrimi i rrezikut, veprimet që duhet ndërmarr, afatet e fundit kohor, sektori përgjegjës, realizimi i planit. Pas aprovimit nga ZKA është dërguar në MF. Sipas Rregulloreve të MFK-së –Procedu-

rat e MFK-së Nr.1 është përgatitur Raporti vjetor për sistemimin e kontrollit të brendshëm dhe Deklarata e Kontrollit të brendshëm”, është aprovuar nga ZKA dhe është dërguar në MeF. AKK ka përgatitur “Pyetësi i Vetëvlerësimit të Komponentëve të Menaxhmentit Financiar dhe Kontrollit”. Pyetësi në përmbajtjen e vet ka 107 pyetje, të cilat lidhen me rregullat kryesore të funksionimit të brendshëm si: objektivat strategjike, rregullat e brendshme, struktura organizative, politika e burimeve njerëzore etj. Ky pyetësor pas aprovimit është dërguar në MF. AKK ka përgatitur propozimet për Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) për vitet 2022-2024. KASH është përgatitur në bazë të kërkesave të njësive kërkuese – Drejtoreshave, e cila në përmbajtjen e saj ka: Misionin, Situatën aktuale, Objektivat, Tabelën financiare me vlerësime 2020-2021 dhe vlerësimet 2022-2024 për kategoritë Paga, Mallra dhe Shërbime, Kapitale, Komunaliteti. Me kërkesën e MF, AKK ka përgatitur planifikimin e buxhetit për vitin 2022-23-24. Planifikimi i buxhetit është bërë në bazë të kërkesave të Drejtorëve të AKK-së, të ndara sipas kategorive ekonomike (Paga, M&SH, Kapitale dhe Komunaliteti). Pjesë e këtij planifikimi është edhe planifikimi i të hyrave për vitin 2022.

6. KORNIZA LIGJORE

Me qëllim të krijimi të Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinorë për Republikën e Kosovës dhe avancimit të kadastrit në Kosovës, AKK ka propozuar në Programin Legjislativ për vitin 2021 dy projekt ligje:

- Projektligjin për krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor në Republikën e Kosovës dhe
- Projektligjin për Kadastrë të Pronës së Paluajtshme.

6.1 PROJEKTLIGJI PËR KADASTËR TË PRONËS SË PALUAJTSHME

1. Çështjet kryesore të trajtuara

Me këtë ligj trajtohet rregullimi i shërbimit publik të regjistrimit të pasurive të paluajtshme në kadastrë, administrimi i kadastrit dhe organizimi i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, si agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Ky ligj në aspektin përmbajtësor përcakton normat dhe përmbajtjen e kadastrit, qasjen në të dhënat kadastrale – më fleksibile dhe me standardet e BE-së, procedurën e unifikuar administrative para Zyrave Kadastrale Komunale dhe Agjencisë Kadastrale Komunale, rindërtimin e informacioneve kadastrale, duke paraparë Komisionin e RIK me kompetenca të zgjeruara sa i përket çështjeve pronësore, organizimin e brendshëm të AKK-së, duke paraparë vertikalizimin e kadastrit në Kosovë, financimin e AKK-së, regjistrimin e pronësisë dhe të drejtave tjera në sende të paluajtshme, licencimin dhe mbikëqyrjen e personave fizik dhe juridik të licencuar etj.

2. Objektivat dhe ndërlidhja e tyre me prioritetet e Qeverisë

Objektivat kryesore të projektligjit janë: unifikimi i dispozitave ligjore që mbulojnë fushën e regjistrimit të pronave të paluajtshme në kadastrë në një ligj të vetëm, organizimi vertikal i kadastrit në Republikën e Kosovës dhe rritja e kompetencave të komisionit të RIK, me qëllim të harmonizimit të gjendjes faktike dhe asaj në regjistër, duke trajtuar edhe disa çështje pronësore siç është legalizimi i shitblerjeve të pa vërtetuara në organin kompetent, trashëgimia etj.

3. Opsioni i rekomanduar

Agjencia Kadastrale e Kosovës ka filluar që nga viti 2016, kur edhe është aprovuar koncepti dokumenti nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Është përzgjedhur opsioni i shkrirjes së dy ligjeve aktuale në fuqi, Ligjit Nr. 2002/5 për Themelimin e RDPP dhe Ligjit Nr. 04/L-013 për Kadastrë, në një ligj të vetëm, e gjithë kjo pas angazhimit të eksperteve të AKK-së dhe pranimit të qëndrimeve praktike nga ana e Zyrrave Kadastrale Komunale. Ky projektligj do të rregullojë çështjen profesionale të fushës së kadastrit në Republikën e Kosovës, përcaktoj mënyrën e organizimit të kadastrit në Kosovë, kompetencat dhe përgjegjësitë e Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Zyrrave Kadastrale Komunale, gjeodetëve dhe kompanive gjeodezike.

4. Vlerësimi i ndikimit financiar të opsionit të propozuar

Kosto të veçantë nuk do të ketë pasi edhe aktualisht, pavarësisht verikalizimit të Zyrrave Kadastrale Komunale, nuk do të shtohet numri i të punësuarve, vetëm se të njëjtët do të kalojnë nga niveli lokal – komunitat, në nivelin qendror – Agjencinë Kadastrale të Kosovës (Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës).

5. Konsultimi i Institucioneve Publike dhe palëve të interesit timet lidhur me ndryshimet rrënjësore që do të pasojnë me hyrjen në fuqi të këtij ligji, duke pasur takimet e rregullta vjetore me ZKK-të në nivel vendi, gjeodetët dhe kompanitë gjeodezike të licencuara, Shoqata e Bankave, Oda e noterëve, Oda e Përmbaruesve si dhe me ekspert vendor e ndërkombëtar.

6. Mënyra e komunikimit të politikës së re për publikun Konsultimet publike janë duke u mbajtur në pajtim me nenin

32 të Rregullores Nr.09/2011 për Punën e Qeverisë së Republikës së Kosovës, në afat prej 15 ditë pune, ndërsa konsultimet paraprake janë realizuar në pajtim me nenin 7 të Rregullores Nr.09/2011 për Punën e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Pas përfundimit të të gjitha procedurave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, ky projektligj dërgohet në Qeveri për aprovim. Projektligji për Kadastër aktualisht është në procedurën e diskutimit publik, ku pas pranimit të komenteve eventuale nga institucionet publike apo grupet tjera të interesit, do të mbahen takimet e grupit punues. Pas hyrjes në fuqi të Ligji për Kadastër të Pronës Paluajtshme, AKK, përkatësisht MMPHI është e obliguar që të filloj me nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatimin e tij dhe të filloj bashkëpunimin me institucionet tjera për fillimin përmbushjes së obligimeve që dalin nga ky ligj.

6.2 PROJEKTLIGJI PËR KRIJIMIN E INFORMACIONIT HAPËSINOR NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

1. Çështjet kryesore të trajtuara

Informacionet hapësinore janë shumë të rëndësishme dhe të domosdoshme për Republikën e Kosovës. Këto informacione janë të rëndësishme edhe për institucionet e ndryshme ndërkombëtare. Në Republikën e Kosovës shumë institucione krijo-

jnë informacione hapësinore në lëmit për të cilat kanë kompetenca dhe përgjegjësi. Informacionet hapësinore përgatiten në formate të ndryshme që shpesh kanë vështirësi në këmbimin dhe përdorimin e tyre nga institucionet e ndryshme të Kosovës por edhe atyre ndërkombëtare që punojnë dhe veprojnë në Republikën e Kosovës. Prandaj është shumë e domosdoshme që informacionet kryesore që krijohen nga institucionet e ndryshme të sistemohen në një bazë të të dhënave që do ta përbëjnë Infrastrukturën kombëtare të informacioneve hapësinore për Republikën e Kosovës dhe për këtë qëllim është iniciuar nxjerrja e këtij projektligji.

2. Objektivat dhe ndërlidhja e tyre me prioritetet e Qeverisë

Objektivat kryesore të projektligjit janë: definimi i qartë i përgjegjësiave, detyrimeve të Institucioneve të Republikës së Kosovës që merren me krijimin e informacioneve hapësinore. Objektivi tjetër i këtij projektligji është edhe përcaktimi i kriterëve për përgatitjen e informacioneve hapësinore që do të jenë pjesë e Infrastrukturës Kombëtare të informacioneve Hapësinore për Republikën e Kosovës.

3. Opsioni i rekomanduar

Opsioni kryesor është nxjerr nga Udhëzimi i Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian për krijimin e Infrastrukturës për informacione Hapësinore në Bashkimin Evropian (INSPIRE) Nr. 2007/02. Ky opsion ka dalë edhe nga takimet që janë mbajtur me shumë Institucione të Republikës së Kosovës siç janë: Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit me departamentet dhe Agjencitë e saj, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave, Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Forcës së Sigurisë, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Korporata Energjetike e Kosovës etj. Krijimi i Infrastrukturës Kombëtare të informacionit Hapësinorë për Republikën e Kosovës është

obligim që del nga legjislacioni i veçantë dhe bazuar në nenin 23 i Ligjit për Kadastër 04/L-013, AKK ka propozuar nxjerrjen e këtij ligji. Me nxjerrjen e Ligjit për krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor në Republikën e Kosovës bëhet zbatimi i Direktivës së Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian për krijimin e Infrastrukturës për Informacione Hapësinore në Bashkimin Evropian (INSPIRE) Nr.2007/02. Në këtë infrastrukturë do të jenë të gjitha të dhënat e grumbulluara nga të gjitha institucionet e veçanta në mënyrë që të përdoren ma lehtë nga të gjitha palët. Kjo do të arrihet duke përcaktuar përgjegjësitë e të gjitha institucioneve përgjegjëse të Republikës së Kosovës ndërsa bashkërendimin sipas Ligjit për Kadastër do ta bëjë Agjencia Kadastrale e Kosovës. Kosto të veçantë nuk do të këtë pasi edhe tani institucionet në Kosovë krijojnë të dhëna hapësinore. Ndërsa këto do të grumbullohen në një bazë që do të mirëmbahet dhe administrohet nga AKK (Gjeoportali për IKIH). Dokumentet bazë në përgatitjen e këtij projektligji janë: Direktiva e Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian për krijimin e Infrastrukturës për informacione hapësinore në Bashkimin Evropian (INSPIRE) Nr.2007/02, ligjet e shteteve të rajonit dhe më gjerë me të cilat është rregulluar kjo fushë, si dhe Ligjet e veçanta të Institucioneve të Kosovës në bazë të cilave krijohen dhe përdoren të dhënat hapësinore.

4. Vlerësimi i ndikimit financiar të opsionit të propozuar

Kosto të veçantë nuk do të këtë pasi edhe tani institucionet në Kosovë krijojnë të dhëna hapësinore sipas buxhetit ekzistues. Pas krijimit të Infrastrukturës për Informacione Hapësinore në Republikën e Kosovës, këto të dhëna do të grumbullohen dhe administrohen nga AKK. Kjo nuk do të krijojë ndonjë kosto të veçantë.

5. Konsultimi i Institucioneve Publike dhe palëve të interesit

Agjencia Kadastrale e Kosovës edhe me herët ka filluar konsultimet lidhur me krijimin e infrastrukturës për informacione hapësinore në Republikën e Kosovës. Agjencia gjatë viti 2012 ka mbajtur me këtë temë edhe një seminar ku kanë qenë shumë pjesëmarrës që krijojnë edhe të dhëna hapësinore, si: Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinore me departamentet dhe Agjencitë e saj, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave, Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Forcës së Sigurisë, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Korporata Energetike e Kosovës, etj.

6. Mënyra e komunikimit të politikës së re për publikun

Mënyra e komunikimit të politikës së re për publikun Përmes ërgatitjes së një plani i cili parasheh organizimin e një fushate për informimin dhe bashkëpunimin fillimisht më të gjithë akterët që do të kenë përfitime nga ky ligj. Në plan do të identifikohet edhe shoqëria civile që kanë interes në qasjen në të dhënat që do të jenë në dispozicion për publikun. Konsultimet publike janë mbajtur në pajtim me nenin 32 të Rregullores Nr.09/2011 për Punën e Qeverisë së Republikës së Kosovës, në afat prej 15 ditë pune, ndërsa konsultimet paraprake janë realizuar në pajtim me nenin 7 të Rregullores Nr.09/2011 për Punën e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Pas përfundimit të të gjitha procedurave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, ky projektligj është dërguar për shqyrtim në Qeveri dhe është aprovuar. Projektligji për krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të In- formacionit Hapësinor në Republikën e Kosovës ka kaluar në lexim të parë në Kuvend dhe i njëjti është në procedurë të shqyrtimit në Kuvend nga Grupi Punues dhe pas përfundimit të shqyrtimit do të votohet. Shqyrtimi i këtij projektligji është duke u bërë nën për nen nga Grupi punues në bashkëpunim me përfaqësues të Agjencisë Kadastrale të Kosovës. Pas hyrjes

në fuqi të Ligji për krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor në Republikën e Kosovës, AKK është e obliguar që të filloj me nxjerrjen e akteve nën ligjore për zbatimin e tij dhe njëkohësisht të filloj bashkëpunimin me institucionet tjera për fillimin e përmbushjes së obligimeve që dalin nga ky ligj e që është standardizimi i të dhënave të prodhuara nga të gjitha institucionet.

6.3 PLOTËSIM NDRYSHIMI I UDHËZIMEVE ADMINISTRATIVE NGA FUSHA E KADASTRIT

Në kuadër të reformave të parapara në kadastër dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarë dhe institucione, AKK ka ndërmarë iniciativën për plotësimin dhe ndryshimin e tri udhëzimeve Administrative të parapara në Planin Legjislativ për aktet nënligjore për vitin 2021, ato janë:

- Udhëzimi Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 08/2019 për Tarifat e Produkteve dhe Shërbimeve të Agjencisë Kadastrale të Kosovës,
- Udhëzimi Administrativ (MMPHI) Nr.05/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MEA) Nr. 09/2020 për Tarifat e Shërbimeve për Regjistrimin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme,
- Udhëzimi Administrativ (MMPHI) Nr. 06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 13/2019 për Licencimin e Kompanive Gjeodete dhe Gjeodetëve.

Pas aprovimit të Planin Legjislativ për aktet nënligjore, janë formuara grupet punuese të udhëhequra nga AKK-ja, të cilët kanë përgatitur draftet e këtyre udhëzimeve dhe të njëjtit i janë nënshtruar procedurave të parapara dhe pas nënshkrimit nga ministri e publikimit në Gazetë Zyrtare janë hy në fuqi.

Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 08/2019 për Tarifat e Produkteve dhe Shërbimeve të Agjencisë Kadastrale të Kosovës

Bazuar në rekomandimin e dhënë nga Ministria e Financave, AKK ka propozuar që në Planin Legjislativ të viti 2021, të propozoi Plotësim Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 08/2019 për Tarifat e Produkteve dhe Shërbimeve të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, me qëllim të trajtimit të tarifave për produktet dhe shërbimet e Agjencisë Kadastrale të Kosovës për Institucionet Publike. Me këtë udhëzim administrativ, janë bërë disa ndryshime, përkatësisht janë evidentuar tarifat për të gjitha produktet e AKK-së, me qëllim që ky akt nën ligjor të e përcaktoj nivelin sa më të arsyeshëm të nivelit të tarifave për institucionet publike. Gjithashtu ka përcaktuar edhe nocionet teknike të cilat përdoren për krijimin e përdoruesve nga institucionet publike dhe ato private me autorizime publike si dhe shtimin e produkteve të reja.

Udhëzimi Administrativ (MMPHI) Nr.05/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MEA) Nr. 09/2020 për Tarifat e Shërbimeve për Regjistrimin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme

Me këtë udhëzimin administrativ, janë bërë disa ndryshime të cilat janë vërejtur se janë në kundërshtim me praktikat më të mira të zbatimit të Ligjit për Kadastër, po ashtu janë paraparë disa raste kur përjashtohet pagesa e tarifave për regjistrimin e të drejtave sendore, sikurse tek rastet e ri regjistrimit, regjistrimit apo modifikimit të barrës apo ngarkesës tjetër, si dhe lirimi nga pagesa i regjistrimit të disa ndalesave. Po është përkufizuar termi “anëtarët e familjes së ngushtë”, për qëllim të përcaktimit të tarifës për regjistrimin e të drejtave sendore. Gjithashtu ndryshim tjetër është bërë tek verifikimi i titullit ju-

ridik, ku tashmë përveç institucionit, kërkesa për verifikim të titullit juridik mund të bëhet edhe nga pala si dhe janë specifikuar disa çështje të cilat mund të kenë mundësi të interpretimit të dyfish. Gjithashtu është krijuar baza ligjore me të cilën obligohen të gjitha përdoruesit e institucioneve publike dhe përdoruesit privat të cilët ofrojnë shërbime publike që të bëjnë shënimin në Regjistrin kadastral, për pronën e paluajtshme që është në procedurë ose është përfunduar. Shënimi i tillë bëhet pa pagesë. Kjo është bërë me qëllim të parandalimit të mundësisë së ke përdorimit të të dhënave dhe ndalimin e mundësisë së realizimit të disa transaksione në të njëjtën kohë. Kryesisht kemi të bëjmë me transaksionet e shitblerjeve dhe lidhja e disa akteve noteriale për të njëjtën paluajtshmëri. Është konsideruar si një mundësi e mirë e parandalimit të zhvillimit të disa transaksioneve në të njëjtën kohë. Shënimi do të ketë kupumin e njoftimit të të gjitha palëve pjesëmarrëse në një procedurë që mund të jetë te noteri, në gjykatë, te përmbaruesi privat apo te cili do institucion tjetër. Vënia e shënimit është e obligueshme për të gjitha institucionet të cilat merren me të drejta pronësore duke përfshirë gjykatat, noterët, përmbaruesit privat, prokurorinë (te rastet e caktimit të masës së sigurisë), Administrata Tatimore etj.

Udhëzimi Administrativ (MMPHI) Nr. 06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 13/2019 për Licencimin e Kompanive Gjeodete dhe Gjeodetëve

Gjatë zbatimit të Udhëzimit Administrativ Nr. 13/2019 për Licencimin e Kompanive Gjeodete dhe Gjeodetëve, janë vërejtë disa zbrazëtira ligjore e të cilat kanë paraqitur problem në mbarëvajtjen e procesit të licencimit të Kompanive Gjeodete dhe Gjeodetëve dhe me qëllim të eliminimit të tyre AKK ka propozuar që në Planin Legjislativ për aktet nënligjore të vitit 2021 plotësim ndryshimin e këtij udhëzimi. Ky udhëzim administrativ do të zbatohet për mënyrën e licencimit të

komanive gjeodete dhe të gjeodetëve në tërë territorin e Republikës së Kosovës siç përcaktohet me Ligjin Nr. 04/L-013 për Kadastër dhe me këtë Udhëzim Administrativ, po ashtu është bërë përcaktimi i rregullave detaje lidhur me kandidatet të cilët kanë të drejtë të aplikojnë për licencim. Ndryshimet kryesore të cilat i ka paraparë ky udhëzim administrativ kanë të bëjnë me kushtet dhe procedurat e licencimit të kandidatëve të cilët aplikojnë për licencim, përkatësisht kushti që një kandidat i cili ka aplikuar për licencim pas aprovimit të kërkesës duhet të dëshmoj se punë primare e ka punën si gjeodet i licencuar, ndërsa si punë sekondare mund të punoj ndonjë punë tjetër publike apo private, po ashtu janë të obliguar të jenë të regjistruar si biznes individual, kufizimi i të drejtës për licencim deri në moshën 65 vjeçare dhe është përcaktuar përmbajtja dhe mënyra e dhënies së testit për licencim. Sa i përket kompanive të licencuara është përcaktuar kompetenca e personave që mund të nënshkruajnë lëndë në emër të kompanisë gjeodezike të licencuar.

7. SISTEMI I INFORMACIONEVE KADASTRALE PËR TOKËN NË KOSOVË

Përveç ushtrimit të mandatin si institucion i shkallës së dytë dhe ofrimit të përkrahjes profesionale dhe ligjore AKK ka realizuar edhe avancime teknologjike për ti përmbushur kërkesat e zyrtarëve të ZKK-ve. Disa nga avancimet e këtij viti të implementuara në Sistemin e Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovës janë përshkruar në vijim:

- Krijimi i mundësisë në SIKTK që gjatë bashkimit të një- sive që kanë hipoteka, të bëhet edhe fshirja e hipotekave të njëjta që dyfishohen pas krijimit të njësisë së re; Ndalimi i regjistrimit të hipotekave nga ZKK-të në formën e vjetër (para avancimit), në rastet që duhet regjistruar për ndonjë arsye në formën e vjetër, leja për këtë regjistrim të mundësohet dhe aprovohet nga AKK;
- Të ndalohet në SIKTK që në gjendjen e re të thirren si pronarë të ri të njësive personat e regjistruar me KCID, në momentin që personat me KCID mbeten pa prona të bëhen jo aktiv me automatizëm nga sistemi;
- Te ndarja dhe bashkimi i njësive kadastrale të lejohet me një proces edhe modifikimi i sipërfaqes;
- Regjistrimi i pronësisë së përbashkët në qirambajtje të ketë mundësi të realizohet pa qenë nevoja e ruajtjes së përpjesës;
- Gjatë regjistrimit të njësive të reja kadastrale ndërtesë, nëse parcela ka hipotekë atëherë e njëjta duhet të përcillet edhe tek ndërtesa e cila regjistrohet si njësi e re mbi atë parcelë;
- Te regjistrimi i lëndës të ketë mundësi të shtohet emri i gjeodetit i cili ka realizuar lëndën në teren;
- Është krijuar mundësia e përpilimit të aktvendimit edhe për rastet kur njësitë e reja që regjistrohen krijohen nga ndarja apo bashkimi i tyre vetëm në pjesën grafike;

- Gjatë bashkimit të njësive kadastrale kur njësitë kanë ngarkesa , duhet krijuar mundësia e fshirjes së tyre me lëndën Bashkim, është realizuar për hipoteka, duhet realizuar edhe për ngarkesa tjera;
- Në certifikatën për njësi kadastrale për ndërtesa dhe pjesë të ndërtesës duhet të shfaqet edhe numri i parcelës;
- Lejimi i ruajtjes së numrit të njëjtë të Kolateral ID-se tek Modifikimi i hipotekave;
- Validim i bazuar në numrin e njësisë kadastrale për kërkesat për hipoteka që vijnë nga bankat, për të pamundësuar dyfishimin e kërkesave të njëjta;
- Numri i telefonit të plotësohet në regjistrim të lëndës në CaseManagement për disa lloje të lëndëve;
- Në exel fajllin që ngarkohet në regjistrimin e pjesëve të ndërtesës në SIKTK i cili në mënyrë automatike plotësohet në aktvendim e mandej në përpunim në SIKTK validimi i pronarit të bëhet vetëm me numër personal dhe jo edhe me emër e mbiemër;
- Te Bashkimi i njësive me hipoteka, validimi i hipotekave ekzistuese të behet vetëm me shumë dhe datë të skadimit dhe jo edhe me prioritet të tyre;
- Mos të ketë mundësi printimi të certifikatës për person nëse ai është vetëm borxhli në hipotekë (kjo vlen edhe për odulet online, e-Kioskë, UCWSS)

Edhe gjatë këtij vitit ka vazhduar bashkëpunimi në mes të DTI dhe OE në administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit kadastral SIKTK-SOA. Sistemi SIKTK-SOA ka qenë i qasshëm dhe funksional në 99.99% të kohës gjatë vitit 2021. Gjatë këtij viti kompania mirëmbajtëse e sistemeve të SIKTK-SOA ka bërë mirëmbajtjen, zhvillimin e shumë kërkesave të reja në SIKTK-T. Po ashtu kjo kompani ka bërë vendosjen e versioneve në ambiente testuese dhe reale të cilat janë zhvilluar si rezultat i kërkesave të shumta që janë drejtuar nga grupi punues i këtij projekti. Deri më tani në SIKTK-T janë vendosur 12 versione në

ambientin real dhe testues , me kërkesa të ndryshme. Po ashtu janë pranuar edhe 12 raporte të mirëmbajtjes së sistemeve nga ana e kompanisë, raportet janë dorëzuar në baza mujore. Në vazhdim është paraqitur një tabelë krahasimore për vitet 2019-2021 e transaksioneve kadastrale nga ZKK-të, përmes Sistemit të Informacionit Kadastral të Tokave në Kosovë (SIKTK). Në Sistemin SIKTK-SOA tek sistemi i menaxhimit të lëndëve janë krijuar dhe konfiguruar 16 shfrytëzues të ZKK-ve dhe ju janë dhënë të drejta sipas kërkesës së dërguar me email nga eprorët, ndërsa janë deaktivizuar 5 shfrytëzues.


Viti	Numri i lëndëve të aprovuara në KCLIS-T	Numri i certifikatave të lëshuara në KCLIS-T
2018	64,897	140,937
2019	67,537	136,749
2020	52,817	113,030
2021	77,957	143,228

Tabela: Numri i lëndëve të aprovuara në SIKTK-T ndër vite


Transaksionet ne SIKTK 2019-2021					
Viti	Lëndë të aprovuara	Lëndë të refuzuara	Lëndë në proces	Certifikata të lëshuara	Total lëndë të trajtuara
2019	68,275	4,179	2,108	136,051	210,613
2020	48,092	2,956	5,612	110,059	166,719
2021	76,115	3,190	8,423	141,390	229,118

Tabela 8: Transaksionet ne SIKTK 2019-2021


Çertifikata të Pronësisë gjatë vitit 2021




Shitblerje gjatë vitit 2021




Hipoteka gjatë vitit 2021



Numri i lëndëve Ndarje e parcelave gjatë vitit 2021



Numri i lëndëve Bashkim i parcelave gjatë vitit 2021



7.1 KORRIGJIMI I TË DHËNAVE

AKK në vazhdimësi monitoron kualitetin e të dhënave kadastrale në SIKTK. Nga analiza dhe monitorimi i të dhënave tekstuale është identifikuar një ga- bim në të dhëna, i cili ka ardhur nga migrimi i të dhënave nga një sistem në tjetrin. Nga procesi i migrimit të të dhënave nga sistemi i KCID-it të azhurnuar në sistemin e RDPP-së person- at të cilët kanë pasur numër të njëjtë të KCID-it në komuna të ndryshme janë mbishkruar., Ppra të dhënat e një personi janë mbishkruar tek të dhënat e një personi tjetër duke ia kaluar ga- bimisht edhe pronat e tij në pronësi të personit të mbishkruar. Persona me nje gabim të tillë kanë qenë afërsisht 300. Gjithash- tu gjatë projektit të Rindërtimit të Informacioneve Kadastrale nga migrimi i të dhënave nga sistemi i CRTOOL-it në SIKTK disa persona janë mbishkruar. Në CRTOOL personat ekzistues me KCID janë modifikuar duke iu vendosur të dhënat perso nale gabim të një personi tjetër apo edhe personi ekzistues në sistem me numër personal është modifikuar duke i vendosur të dhëna të një personi tjetër. Pas migrimit të këtyre të dhënave në SIKTK këto raste kanë ngatërruar pronarët. Persona me gabim të tillë kanë qenë afërsisht 60. Këto të dhëna janë korigjuarkorigjuar. në mënyrë që pronat të kthehen tek pronarët e vërtetë të tyre.

7.2 SISTEMI I INFORMACIONEVE KADASTRALE PËR TOKËN NË KOSOVË - HARTA KADASTRALE

SIKTK-HK është sistem i bazuar në UEB me bazë të centralizuar të të dhënave. Sistemi përmban të gjitha veglat e duhura për mirëmbajtjen e Hartës Kadastrale bazuar në legjislacionin në fuqi (ligjet, udhëzimet administrative, kornizat e punës dhe doracakët). Përdoruesit janë në gjendje të bëjnë të gjitha operacionet bazike të administrimit të sistemit, menaxhimit të shfrytëzuesve dhe menaxhimit të rasteve. Gjithashtu , impor-

timin e të dhënave nga disa formate të ndryshme si dhe përpunimin e të dhënave kadastrale në hartë. Më poshtë janë të listuara disa nga funksionalitetet bazike të sistemit:

- Shikimi në hartë Administrimi i shfrytëzuesve Administrimi i aplikacionit
- Administrimi i veçorive të krijuara
- Funksionet bazike të editimit të të dhënave (kopjimi, lëvizja, etj)
- Menaxhimi i rasteve dhe proceseve

Edhe gjatë këtij viti është vazhduar me administrimin e sistemit SIKTK-HK, sistem i cili ka qenë i qasshëm dhe funksional në 99.9% të kohës. Gjatë gjithë vitit i është ofruar përkrahje dhe mbështetje e vazhdueshme zyrtarëve të ZKK-ve që punojnë në aplikacionin SIKTK-HK. Gjithashtu janë monitoruar serverët dhe është bërë përcjellja e tyre në vazhdimësi, janë monitoruar CPU dhe Memoria e këtyre serverëve. Këtë vit janë krijuar 6 shfrytëzues të ri nga ZKK-të si përdorues bazik të cilët punojnë në sistemin SIKTK-HK dhe dy shfrytëzuesve të tjerë i janë shtuar të drejta të reja.

7.3 MIGRIMI I TË DHËNAVE NË SIKTK-HARTA KADASTRALE

Duke u bazuar në kërkesën e Komisionit për RIK dhe grupit punues është iniciuar projekti për azhurnimin dhe plotësim e të dhënave grafike në SIKTK-HK. Bazuar në kërkesën e komisionit dhe grupit punues, AKK ka marrë mbështetje nga Autoriteti Norvegjez për Hartografi “Statens Kartverk” për financimin e realizimit të këtij aktiviteti.

Në kuadër të këtij projekti janë realizuar aktivitetet si në vijim:

- Azhurnimin e parcelave të krijuara nga ZKK-të në zonat e përfshira në projekte të ndryshme të RIK-ut, e të

- cilat nuk kanë qenë të azhurnuara në SIKTK-HK;
- Korrigjimin e disa parcelave informale të cilat kanë qenë të krijuara ne bazën grafike SIKTK-HK, por jo edhe në SIKTK-Tekst;
- Analizimin dhe filtrimin e ndërtesave në zonat e përfshira në RIK, me qëllim të ndarjes së grupit të ndërtesave të krijuara gjatë RIK-ut (pa leje ndërtimi dhe pa leje përdorimi) dhe atyre të krijuara në mënyrë sporadike nga ZKK-të si ndërtesa më leje ndërtimi dhe leje përdorimi. Kërkesa ka qenë që te largohen nga SIKTK-HK vetëm ndërtesat pa leje dhe te ruhen në formatin për ngarkim në Gjeoportali si kategori e veçantë;
- Azhurnimin e disa manualeve me parcela të regjistruara në SIKTK-Tekst por jo edhe në SIKTK-HK, si psh, një numër i konsiderueshëm i parcelave në ZKK Prishtinë, Lagja e ashtuquajtur (Pllacet Kashagi);
- Azhurnimi i bazës grafike komform asaj tekstuale bazuar në disa planë të ri gjetura origjinale për: Fushë Kosovë (ZK Fushë Kosovë), Mitrovicë (ZK Shupkovc) dhe Lipjan (ZK Banullë);
- Pas hartimit të specifikave teknike është arritur akordimi që procedurat e prokurimit për këtë aktivitet të zhvillohen nga AKK-NjiP, duke e bazuar në rregullat e prokurimit të Bankës Botërore.

Nënshkrimi i kontratës me OE është bërë në Mars 2021 dhe menjëherë kanë filluar aktivitete e parapara në Specifika Teknike si:

- Dorëzimi dhe aprovimi i raportit fillestar;
- Trajnimi dhe dhënia e qasjes së tre shfrytëzuesve në SIKTK-HK;
- Dorëzimi i të dhënave për azhurnim të parcelave dhe listës së zonave për trajtim të ndërtesave;
- Dorëzimi i raportit të parë me informacione dhe të dhë-

- na për aktivitetet e kryera nga OE;
- Kontrolli i kualitetit nga ekspertë të AKK-së për të dhënat e raportuara nga OE;
- Rishikimi dhe Aprovimi i raportit të parë;
- Dorëzimi i të dhënave shtesë nga dorëzimi i parë për
- azhurnim të parcelave nga OE në SIKTK-HK;
- Kontrolli i kualitetit nga ekspertë të AKK-së për të dhënat e raportuara nga OE
- Dorëzimi i raportit përfundimtar me informacione dhe të dhëna për aktivitetet e kryera nga OE
- Rishikimi dhe Aprovimi i raportit përfundimtar.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur numri i njësive të përpunuara nga OE dhe aprovuara nga AKK

Aktiviteti	Lloji i njësisë	Numri i njësive të aprovuara
Përmirësimi i ndërtesave brenda Zonës Kadastrale	Zonë Kadastrale	120
Përmirësimi i Parcelave nga Projektet e mëparshme të Rindërtimit	Parcelë	2029
Përmirësimi dhe plotësimi i të dhënave të pa azhurnuara në SIKTK-HK	Parcelë	807

Tabela 8. Numri i njësive të përpunuara nga OE dhe aprovuara nga AKK

8. LICENCIMI I GJEODETËVE DHE KOMPANIVE GJEODETE

Duke marr për bazë Ligjin për Kadastër Nr. 04/-L-013 Agjencia Kadastrale e Kosovës përkatësisht Komisioni për Licencim ka

realizuar edhe një prej obligimeve dhe përgjegjësive që derivojnë nga ky ligj dhe aktet nënligjore që ka të bëjë me Licencimin e kompanive gjeodete, gjeodetëve dhe teknikëve gjeodet. Gjatë vitit 2021 kanë aplikuar 71 persona dhe janë shqyrtuar në katër periudha vjetore (Janar, Mars, Qershor dhe Shtator) ashtu siç është e përcaktuar me Udhëzimin Administrativ nr. 13/2019 për Licencimin e Kompanive Gjeodete dhe Gjeodetëve. Pas kalimit të fazës së aplikimit si mekanizëm për ngritje profesionale të gjeodetëve kandidat për licencim, AKK kishte ofruar materiale të mjaftueshme dhe mbajtur trajnime me temat si matjet kadastrale e gjeodezike në terren, pjesa grafike dhe tekstuale e Sistemit të Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë, KOPOS-i etj. Pas trajnimit dhe ofrimit të materiale relevante, u realizua testimi përmes aplikacioneve të veçanta, me anë të së cilave AKK përkatësisht Komisioni për Licencim siguroi transparencë maksimale të gjithë këtij procesi. Nga 71 aplikimet, në afatin e muajit Janar 2021 kanë aplikuar 24 persona, ku nga këta persona janë licencuar 13 persona, përkatësisht 1 teknik gjeodet, 1 kompani gjeodete dhe 11 gjeodet të licencuar. Në afatin e muajit Mars 2021 kanë aplikuar 16 persona, ku nga këta persona janë licencuar 13 persona, përkatësisht 6 kompani gjeodete dhe 7 gjeodetë të licencuar. Në afatin e muajit Qershorit 2021 kanë aplikuar 18 persona, ku nga këta persona janë licencuar 12 persona, përkatësisht 4 kompani gjeodete dhe 8 gjeodet të licencuar. Në afatin e muajit Shtator 2021 kanë aplikuar 13 persona, ku nga këta persona janë licencuar 7, përkatësisht 1 kompani gjeodezike, 1 teknik gjeodet dhe 5 gjeodet të licencuar. Më poshtë e gjeni në formë tabelare numrin e kërkesave, licencave të aprovuara dhe numrin e përgjithshëm të licencave.

Periudha e aplikimit	Numri i aplikuesve	Numri i zyrave të kontrolluara	Numri i licencave për kompani gjeodezike	Numri i licencave për teknik gjeodetë	Numri i licencave për gjeodetë
Janar 2021	24	13	1	1	11
Mars 2021	16	13	6	0	7
Qershor 2021	18	12	4	0	8
Shtator 2021	13	7	1	0	6
Gjithsej	68	45	12	1	32

Tabela 9. Numri i kërkesave, licencave të aprovuara dhe numri i përgjithshëm të licencave

AKK, përkatësisht Komisioni për Licencimin e Kompanive Gjeodete dhe Gjeodetëve, ka monitoruar në vazhdimësi personat fizik dhe juridik, të cilët gjithashtu janë njoftuar me hyrjen në fuqi të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 13/2019 për Licencimin e Kompanive Gjeodete dhe Gjeodetëve. AKK, gjithashtu ka paraqitur rekomandimet dhe sugjerimet për mbarëvajtjen e punëve të personave fizik dhe juridik të licencuar, duke kërkuar nga të njëjtët raportin vjetor për të gjitha llojet e lëndëve të kryera gjatë vitit 2021.

MENAXHIMI I APLIKACIONI PËR TESTIM ONLINE TE GJEODETËVE

Gjatë vitit 2021 janë mbajt katër testime online për Licensimin e Gjeodetëve të mbajtura në periudha të ndryshme të vitit:

Testi i parë është mbajt me 23 shkurt 2021 dhe në aplikacionin speedexam janë krijuar dhe konfiguruar 24 kandidatë. Këta 24 kandidatë janë ndarë në dy grupe ku secili grup i ka pasur nga 12 kandidatë.

Testi i dytë është mbajt me 28 prill 2021 dhe në aplikacionin speedexam janë krijuar dhe konfiguruar 16 kandidatë . Këta 16 kandidatë janë ndarë në dy grupe ku secili grup i ka nga 8 kandidatë.

Testi i Tretë është mbajt me 09 korrik 2021 dhe në aplikacionin speedexam janë krijuar dhe konfiguruar 17 kandidatë . Këta 17 kandidatë janë ndarë në dy grupe ku grupi I ka pasur nga 8 kandidatë dhe grupi II i ka pasur 9 kandidatë.

Testi i katërt është mbajt me 21 tetor 2021. Në testin online për Licencimin i Gjeodetëve kanë marrë pjesë 13 kandidatë. Gjithashtu edhe këta janë ndarë në dy grupe njeri me 6 kandidatë dhe grupi tjetër 7 kandidatë.

Afati kohor ka qenë i limituar , 45 minuta nga momenti i qasjes në test. Numri i pyetjeve që janë vendosur ka qenë 30c me një ose më shumë përgjigje të sakta. Për çdo test janë konfiguruar pyetje të reja.

Është konfiguruar që përqindja minimale e kalueshmërisë që të jetë 70% dhe paraqitja e pyetjeve në test për secilin kandidat të jetë e ndryshme.

Kandidatët nuk kanë pasur mundësi që kur të përfundohet testi të rikthehen prapë në test .

Momentin që përfundohet testi kandidatët e kanë pranuar rezultatin me përqindje Pass ose Fail.

9. MONITORIMI I ZYRAVE KADASTRALE KOMUNALE, KOMPANIVE TË LICENCUARA GJEODETE DHE GJEODETËVE TË LICENUAR

Që nga viti 2014, AKK ka realizuar monitorime të rregullta, ku për secilin prej tyre janë hartuar raportet dhe të njëjtat janë dërguar tek Zyret Kadastrale Komunale. Monitorimi i këtij viti është i teti (8) me radhë dhe është i ndarë në tri pjesë, duke përfshi pjesën grafike, pronësore-juridike dhe pjesën tekstuale. Monitorimi i aktiviteteve për zyrën kadastrale komunale përfshinë periudhën nga muaji Dhjetor 2019 deri në muajin Mars të vitit 2020, ku nga kjo periudhë kohore janë ekstraktuar dhe kontrolluar lëndë të cilat kanë qenë të azhuruara në Sistemin e Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë për pjesën tekstuale (SIKTK-T) dhe në pjesën grafike të (SIKTK-HK). Lëndët të cilat janë kontrolluar në aspektin teknik dhe ligjor kanë të bëjnë me ndarje dhe bashkim të parcelave, regjistrim të ndërtesave dhe pjesëve të ndërtesës, shitblerje, trashëgimi, hipotekë, etj. Për të gjitha këto lëndë, të përzgjedhura në mënyrë të rastësishme nga sistemi, është kontrolluar edhe procesi i azhurnimit në SIKTK. Për shkak të pandemisë procesi i monitorimit nuk ka arrite të përfundojë, pasi disa të dhëna është dashtë të mirren nga Zyra Kadastrale Komunale. Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) mbi bazën ligjore të nenit 4 parag. 9, 10, 11 ndërlidhur me nenin 6 të Ligjit Nr. 04/L- 013 për Kadastër dhe mbi bazën e aktit nënligjor - Udhëzimin Administrativ Nr. 13/2019 për Licencimin e Kompanive Gjeodete dhe Gjeodeteve, ka kompetencë ligjore për licencimin dhe monitorimin e të gjithë personave fizik dhe juridik të licencuar. AKK përmes pranimit të ankesave bën kontrollimin dhe monitorimin administrativ të gjeodeteve të licencuar dhe kompanive gjeodete. AKK gjatë vitit 2021, nuk ka bërë monitorim të lëndëve, mirëpo janë trajtuar një mori ankesash dhe për të njëjtat brenda afatit ligjor ka dhënë përgjigje. AKK gjatë vitit 2021, gjatë procedurës së licencimit ka kontrolluar mbi 45

zyra në tërë territorin e Republikës Kosovës, ku shumica e tyre kanë selinë në qytetet kryesore e veçanht në Prishtinë. AKK gjatë janarit të vitit 2022, nga të gjithë personat fizik dhe juridik të licencuar, ku kanë raportuar për numrin e lëndëve, llojin e tyre dhe territorin komunal në kuadër të cilave ZKK janë kryer.



10. SHPRONËSIMI

Shpronësimi dhe regjistrimi i shpronësimit në regjistrat kadastral bëhet sipas ligjit Nr. 03/L-139 Për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Neni 12 Regjistrimi i vendimit të shpronësimit në kadastrë, i cili specifikon si në vijim:

- Menjëherë pas miratimit të Vendimit Përfundimtar me të cilin autorizohet shpronësimi i pronës së paluajtshme dhe dorëzimit nga Organi Shpronësues organi ose organet përkatëse kadastrale e regjistrojnë vendimin.
- Pas regjistrimit, të gjithë Pronarët dhe Zotëruesit e Interesit në pronën përkatëse janë të ndaluar që të bartin ose dhurojnë, ose të tentojnë të bartin ose dhurojnë, një pale të tretë çfarëdo të drejta pronësore ose të drejta apo interesa tjera mbi pronën përkatëse dhe të kryejnë punë ndërtimore në, mbi ose nën sipërfaqen e pronës në fjalë.

Procesi pas vendimit përfundimtar dhe regjistrimit të vendimit të shpronësimit

Procesi i regjistrimit të vendimeve përfundimtare për parcelat që preken nga shpronësimi është duke vazhduar me një ritëm të ngadalshëm nëpër Zyrat Kadastrale Komunale. Pasi që të dërgohet vendimi përfundimtar nga organi i shpronësimit në ZKK atëherë ato duhet të fillojnë të bëjnë regjistrimin e vendimit përfundimtar për parcelat që preken nga vija e shpronësimit, pastaj fillon ndarja e parcelave të cilave u merret një pjesë e sipërfaqes së parcelës e cila shpronësohet edhe pas ndarjes së parcelës e cila krijohet në bazë të elaboratit të shpronësimit fillojnë bartja e pronës në emër të organit të shpronësimit. E gjithë procedura pas vendimit përfundimtar vazhdohet në ZKK e kjo shkakton edhe ngec pasi që disa ZKK ka mungesë të stafit profesional, në disa raste mungojnë ndarjet e parcelave në hartat kadastrale për parcelat të cilat preken nga vija e shpronësimit

ndërsa këto parcela janë të ndara në bazë të dhënave tekstuale, mungesa e elaboreve të shpronësimit dhe vendimeve përfundimtare nëpër ZKK, gabime teknike në elaboratin e shpronësimit, mos njohja e proceduarve edhe proceseve të shpronësimit nga stafi i ZKK-ve. Në shumicën e ZKK-ve regjistrimi i njësive të shpronësimit bëhet sipas kërkesës së pronave rast për rast, ndërsa rastet për të cilat palët nuk shprehin interes nuk trajtohen në shumicën e ZKK-ve, me që rast nuk azhurnohet elaborati i shpronësimit. AKK bazuar në mandatin dhe përgjegjësinë e saj, ka ngritur në nivelet më të larta çështjen e pamundësisë së azhurnimit në Kadastër të elaboreve të shpronësimit. Përveç kësaj ka propozuar edhe zgjidhje konkrete se si do të mund të zgjidhej kjo çështje, e ku besojmë se gjatë vitit 2022 bashkë me akterë të tjerë institucional do të gjendet një zgjidhje adekuate.

11. KOMASACIONI

Komasacioni apo rregullimi i tokave është një proces shumë i nevojshëm për administrimin e tokës duke eliminuar fragmentimin e saj, njëkohësisht duke ngritur kualitetin me sistem të ujitjes, rrugë dhe parcela kadastrale më të mëdha dhe nw sipërfaqe në formë të rregullt gjeometrik. Fatkeqësisht regjistrimi i projekteve të Komasacionit në Kadastër ka patur shumë vështirësi. AKK ka pranuar kërkesa të shumta nga pronaret, për pronat që gjinden në zonat në Komasacion. Deri me tani nëpër Zyrat Kadastrale Komunale të dhënat grafike për komasacion i kanë shfrytëzuar në formatin ITF. Përmes softwerit Geomedia dhe Geospro. Kopja e planit është lëshuar përmes softwerit GeosPro. Tani në hartën kadastrale nuk janë migruar të gjitha zonat kadastrale për pjesën e Komasacionit. AKK- ka kërkuar nga ZKK të dërgojnë të dhënat të cilat i posedojnë nga Komasacioni. AKK ka realizuar disa takime, dhe në muajin dhjetor ka realizuar takim pune në zyrat e AKK-së me zyrtaret komunal nga Zyra Kadastrale Prizren, Rahovec, Gjakovë si dhe Drenas. Të dhënat janë dërguar në Zyrat Kadastrale për kontroll të kualitetit dhe janë në pritje të kontrollit të kualitetit, për zonat kadastrale të Prizrenit, Gjakovës, Rahovecit , me pastaj të një- jtat do të migrohen në pjesën grafike. AKK-ka bërë migrimin e të dhënave në hartën kadastrale për zonën kadastrale Doberdoll, Trakaniq dhe Janoshë, Zonat tjera janë në procedurë të kontrollit të kualitetit.

12. LEGALIZIMI

AKK gjatë muajit tetor-nëntor 2021 ka marrë pjesë në punëtorinë e organizuar nga USAID “Punëtorinë mbi implementimin e programit të legalizimit të ndërtimeve pa leje”. Përfaqësuesit e USAID-it kanë prezantuar rezultatet e dy komunave me të cilat e kanë zhvilluar projektin e tyre-programin e legalizimit të ndërtimeve pa leje, si Komunës Prishtinës dhe Graçanicës, gjithashtu janë prezantuar sfidat me të cilat po ballafaqohen këto dy komuna të cilat janë kryesisht me mungese të stafit dhe mospërputhja e regjistrit kadastral me gjendjen faktike në terren, përkatësisht mungesa e regjistrimit të të drejtave pronësore. AKK ka dhënë mbështetjen e saj për raste individuale në aspektin teknik dhe ligjor, megjithatë tema të cilat janë paraqitur dhe lidhen drejtpërdrejt me regjistrimin e të drejtave pronësore në regjistër kanë qenë:

- Mënyra e zbatimit të kornizës së punës AKK 2020/01 për matje, krijimin dhe regjistrim të njësive kadastrale konkretisht pikës 16.1 Trajtimi i ndërtimeve pa leje, nga gjeodet dhe kompanitë gjeodete të licencuara. Zyrtaret nga sektori i legalizimit të komunës së Prishtinës kanë kërkuar nga AKK, konkretisht nga komisioni për licencim që të dërgoj një vërejtje tek të gjithë gjeodet dhe kompanitë gjeodete të licencuara lidhur me disa nga gabimet teknike të cilat i kanë listuar në e-mail. Për këtë janë njoftuar të gjithë gjeodetet me rastin e kërimit të raportit vjetor 2021.
- Funksionimi i SIKTK-së, ku është konstatuar nga udhëheqësit e punëtorisë dhe të pranishmit që AKK ka qenë shumë bashkëpunuese lidhur me zhvillimet në sistem sipas kërkesave të cilat kanë dalë gjatë procesit të legalizimit, e sidomos gjatë vitit 2020-2021.
- Shqyrtimi i kërkesave për kategorinë e II-të ndërhyrje pa leje në objekte me leje, ku në këto raste komuna e

Prishtinës i ka fut në listë të pritjes për shkake të ndryshimit të sipërfaqes në mes grafikes dhe tekstuales, është sqaruar se ky dallim vjen për shkak të sipërfaqes NETO dhe BRUTO, dhe si të tilla nuk duhet të futen në listë të pritjes;

- Dëshmia e transaksionit bankar për shitblerjen mbi 10.000,00€ për kategorinë e II-të konkretisht për regjistrimin e njësive banesore, për këtë pikë është sqaruar dhe është interpretuar ligji për legalizim i cili nuk e përjashton këtë kërkesë dhe si e tillë po pamundëson procesin e legalizimit për kategorinë e II-të,
- AKK gjithashtu ka dhënë mbështetjen e saj profesionale dhe të prezantimit aty për aty të rasteve të cilat kanë ardhur si pasojë e proceseve të legalizimit me ankesa në AKK, si organ i shkallës dytë, zgjidhjet që janë bërë apo rekomandimet e nevojshme në rast se vije deri tek plotësim/ndryshimi i ligjit për legalizim apo nxjerrja e një ligji të ri në të ardhmen, me të vetmin qëllim që legalizimit të objekteve pa leje të ju vihet në dispozicion edhe regjistrimi i tyre në kadastrë.

13. INFRASTRUKTURA KOMBËTARE E INFORMACIONEVE HAPËSINORE

Implementimi i IKIH-së është i një rëndësie të veçantë për Republikën e Kosovës, pasi vendi përditë e më shumë po ballafaqohet me rritje të kërkesës për informacione hapësinore, të cilat janë të nevojshme për planifikim dhe vendimmarrje. Sipas Nenit 23 të Ligjit për Kadastrë (Ligji Nr 04/L-013), Agjencia Kadastrale e Kosovës është autoriteti përgjegjës për themelimin dhe koordinimin e IKIH. IKIH në Republikën e Kosovës është duke u implementuar në mënyrë të tillë që aktualisht një kategori e informacioneve hapësinore, respektivisht ato informacioneve hapësinore të cilat janë ofruar prej institucioneve publike e të cilat deri në një masë plotësojnë kushtet nga pikëpamja e kualitetit e saktësisë, janë duke u ruajtur, vënë në dispozicion dhe mirëmbajtur në nivelin më të përshtatshëm duke bërë të mundshme që të njëjtat, në pajtueshmëri edhe me akte tjera ligjore e standarde teknike, të kombinohen nga burime të ndryshme nga të gjitha institucionet në mënyrë të qëndrueshme. Për të mundësuar implementim praktik të konceptit për IKIH, që nga viti 2012 Agjencia Kadastrale e Kosovës në cilësinë e koordinatores dhe disa institucione tjera publike në cilësinë e palëve të interesit në fushën e IKIH, kanë ndërmarë veprime konkrete nga aspekti organizativ, ligjor e teknologjik. Janë krijuar një numër i ueb shërbimeve për disa tema të informacioneve hapësinore dhe për disa nga temat janë krijuar edhe meta të dhëna. Po ashtu AKK krijuar edhe Gjeoportalin Shtetëror, një adresë të vetme për grumbullimin, shkëmbimin dhe shpërndarjen e informacioneve hapësinore të cilat janë prodhuara nga institucione publike në Republikën e Kosovës. Aktualisht në Gjeoportali shtetëror ka rreth 85 të dhëna grafike të qasshme si për kërkim po ashtu edhe shikim të prodhuara nga disa institucione publike, respektivisht nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Agjencia Kadastrale e Kosovës, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit, Min-

istria e Bujqësisë, Agjencia e Statistikave e Kosovës, Komisioni për Miniera dhe Minerale, KEK-u etj. Duke marrë parasysh faktin se shumë nga këto shërbime të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, si strategjia për IKIH dhe Gjeoportali shtetëror janë zhvilluar vite më parë dhe të njëjtat tani më nuk i plotësojnë të gjitha nevojat e palëve të interesit në fushën e IKIH, AKK ka paraparë që në kuadër të Projektit për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme në Kadastër dhe për IKIH, huamarrje kjo nga Banka Botërore, të bëjë azhurnimin dhe plotësimin e strategjisë po ashtu edhe Gjeoportalin e ri për IKIH. Si përfundim, me angazhimin e AKK dhe me përkrahjen ekspertëve vendor dhe ekspertëve nga shtetet anëtare të BE-së, Republika e Kosovës tani më ka vendosur bazat e implementimit të një infrastrukture moderne të informacioneve hapësinor dhe është duke ndjekur praktikën më të mirë të shteteve të tjera anëtare të Bashkimit Evropian në linjë me Direktivën INSPIRE.

Gjeoportali Shtetëror

Gjatë vitit 2021 është vazhduar me ritmin e njëjtë të mirëmbajtjes së Gjeoportalit si edhe në vitet e kaluara. Mund të themi se në 98.45% të kohës Gjeoportali ka qenë i qasshëm dhe funksional. Në këtë vit nuk është shfaq asnjë problem i madh i cili do të mund të pengonte funksionimin normal të Gjeoportalit. Është vazhduar me publikimin e të dhënave të ndryshme nga Institucione të ndryshme në Gjeoportali, si dhe me përditësimin e të dhënave aktuale të cilat janë të publikuara në Gjeoportali. Gjithashtu gjatë këtij viti janë publikuar 11 shtresa të reja në Gjeoportali dhe janë zëvendësuar 2 shtresa me të dhëna më të përditësuara të cilat janë si në vijim:

Nr.	Emri i shtresës
1.	Ortofoto 2018 Malore (Agjencia Kadastrale e Kosovës)
2.	Zonat Postale (Agjencia Kadastrale e Kosovës)
3.	Gjeodetët (Agjencia Kadastrale e Kosovës)
4.	Harta Topografike 1:250000 (Agjencia Kadastrale e Kosovës)
5.	Ujësjiellësi (KRU Gjakova)
6.	Ujëmbledhësit (KRU Gjakova)
7.	Kanalizimi Atmosferik (KRU Gjakova)
8.	Pusetët e Kanalizimit Atmosferik (KRU Gjakova)
9.	Kanalizimi Fekale (KRU Gjakova)
10.	Pusetët e Kanalizimit Fekale
11.	KR01 Gypi - Zona e Ujitjes (KRU Gjakova)
Shtresat e zëvendësuar	
1.	Lumë
2.	Liqe

Tabela 11. Shtresat e azhurnuar në gjeoportalin shtetëror gjatë vitit 2021

Përdorimi i Gjeoportalit, shfrytëzimi sipas shteteve, kohës dhe gjinisë

Përdorimi i Gjeoportalit në këtë vit ka pas një rritje të madhe në krahasim me vitet e kaluara. Gjatë vitit 2021 Gjeoportali është përdorur nga më shumë se 251,000 shfrytëzues ose rreth 28% më shumë se viti 2020 i cili kishte me shume se 195,000 shfrytëzues. Rritja e përdorimit të Gjeoportalit ndër vite paraqitet në tabelë në vijim:

Viti	Numri i shfrytëzuesve	Rritja në përqindje
2016	108000	-
2017	131000	21%
2018	162000	23%
2019	170000	5%
2020	195000	14%
2021	251000	28%

Tabela 10. Rritja e numrit të përdoruesve të gjeoportalit shtetëror ndër vite

Shfrytëzimi më i madh i Gjeoportalit bëhet nga qytetarët e Kosovës rreth 84%, Shqipërisë 7%, Serbisë 2%, Gjermanisë 1.5%, Zvicrës 1.5% dhe të tjera. Koha kur Gjeoportali përdoret më së shumti është nga e Hëna deri të Premten prej orës 09:00 deri në ora 15:00 me nga 8000 deri në 10000 shfrytëzues, pastaj nga ora 08:00 deri në orën 09:00 dhe nga ora 16:00 deri në orën 22:00 me nga 6000 deri në 8000 shfrytëzues. Gjeoportali përdoret edhe gjatë vikendit me nga 6000 deri në 8000 shfrytëzues gjatë ditës, ndërsa koha kur Gjeoportali përdoret më së paku është gjatë natës deri në 2000 shfrytëzues. Në përgjithësi Gjeoportali shfrytëzohet më të shumë nga gjinia mashkullore me rreth 68% sesa nga gjinia femërore me rreth 32%. Ndërsa vetëm gjatë vitit 2021 përqindja e shfrytëzimit të Gjeoportalit nga gjinia femërore është rrit afër 40%.

14. SISTEMI I UNIFIKUAR I ADRESAVE

Projekti i Bankës Botërore për kompletimin e Sistemit të Adresave

Projekti i Bankës Botërore për Sistemin e Adresave përbëhet nga disa komponentë, siç janë: përditësimi i të dhënave të adresave në teren, sinjalizimi i emrave të rrugëve dhe numrave të hyrjeve, ndërlidhja e regjistrit të adresave me regjistrin civil dhe krijimi i një aplikacioni të adresave SIRA mobile. Në kuadër të projektit të Bankës Botërore për kompletimin e Sistemit të Adresave, njësia e adresave ka ndërmarr disa aktivitete, siç janë: përgatitja e projekt propozimit, përgatitja e dokumenteve tenderuese, specifikave teknike, kalkulimi i statistikave, vlerësimi i projektit, diskutim përkitazi me projektin me përfaqësuesit e Bankës Botërore;

Ndërlidhja e Regjistrit të adresave me Regjistrin e Gjendjes Civile

Ky aktivitet është iniciuar nga Zyra e Kryeministrit në kuadër të rekomandimeve nga Zyra e BE-së në Kosovë për reformën zgjedhore të programit ERA 2. Qëllimi i ndërlidhjes së dy regjistrave është që qytetarët të pajisen me adresa zyrtare në regjistrin civil, më pastaj përmes regjistri civil të përditësohen edhe bazat e të dhënave të institucioneve dhe kompanive tjera me adresa zyrtare dhe me këtë të unifikohet përdorimi i adresave. Me këtë proces do të përmirësohen shërbimet ndaj qytetarët si në aspektin kohor ashtu dhe atë kualitativ. Për të realizuar ndërlidhjen e dy regjistrave, palët (ZKM, AKK dhe ARC) janë pajtuar që të realizojnë një pilot projekt, me mbështetje të GIZ-it, në komunat Istog dhe Mitrovicë e Jugut. Pilot projekti përfshinë krijimin e një aplikacioni të ndërmjetëm për ndërlidhje dhe mbledhjen e të dhënave në teren. Rezultatet e pilot projektit më pastaj të përdoren edhe në realizimin e projektit të para- parë me BB-në. Në kuadër të këtij aktiviteti, Njësia e Adresave në kuadër të AKK-së ka ndërmarrë disa hapa, siç

janë: për- gatitja e kronologjisë së punëve që janë ndërmarre përkitazi me ndërlidhjen e adresave në sistemin e gjendjes civile gjatë periudhës 10 vjeçare, pjesëmarrja në punëtorinë e organizuar enkas për këtë proces, përpilimin e Memorandumit të Bash- këpunimit, Projekt propozimin, procedurat standarde të oper- imit, termat e referencës për aplikacionin dhe mbledhjen e të dhënave në teren etj.

Projekti i prodhimit dhe instalimit të tabelave të numrave të adresave për komunat Ferizaj, Viti, Kamenice, Obiliq, Malisheve dhe Kline,

Qeveria Norvegjeze përmes Autoritetit për Hartografi të Norvegjisë ka ofruar një mbështetje për sinjalizimin e tabelave të numrave të hyrjeve në 6 komuna. Ky projekt është realizuar përmes bashkëfinancimit me komunat, ku një pjesë të numrave janë financuar nga Qeveria Norvegjeze kurse pjesën tjetër nga vetë komunat. Në kuadër të këtij projekti janë nënshkruar edhe Memorandumet e Bashkëpunimit me komunat ku janë përcaktuar edhe përgjegjësitë e palëve, duke u bazuar edhe në obligimet ligjore. Në kuadër të projektit Njësia e Adresave në kuadër të AKK-së ka ndihmuar projekti përmes përgatitjes së specifikave teknike, kalkulimi statistikave, përgatitja e raporteve të numrave për secilën rrugë, trajnimi i stafit të komunave rreth instalimit të tabelave të numrave, mbështetje profesionale dhe teknike për komunat, takime në komuna rreth planit të implementimit të projektit, monitorimin e procesit të punës etj.;

Ndërlidhja e Regjistrimit të Adresave me regjistra tjerë të rëndësishëm dhe përpos ndërlidhjes së Regjistrimit Civil me Regjistrin e Adresave, me rëndësi për unifikimin e përdorimit të adresave është edhe ndërlidhja e Regjistrimit të Adresave edhe me regjistra tjerë me rëndësi siç janë:

Ndërlidhja e Regjistrimit të Adresave me Regjistrin e ARBK-së dhe ATK-së; Përdorimi i Adresave zyrtare nga ana e Postës së

Kosovës; Ndërlidhja e Regjistrit të Adresave me Regjistrin e KEDS- it etj. Me që ndërlidhja e Regjistrit Civil me Regjistrin e Adresave nuk përfshinë edhe bizneset por vetëm qytetarët, shumë me rëndësi për kompletimin e përdorimit të adresave zyrtare dhe unike është edhe ndërlidhja e Regjistrit të Adresave me Regjistrin e ARBK-së dhe ATK-së. Në këtë kontekst AKK, në kuadër të forumit për shkëmbimin e të dhënave dhe grupit punues për standardizimin e shfrytëzimit të të dhënave të adresave, iniciuar nga ATK me mbështetje edhe nga projekti i BB për ATK, ka ndërmarrë disa aktivitete, si: realizimin e takimeve me palët e përfshira në këtë proces, ARBK, ARC, ATK dhe ASK, ofrimin e të dhënave të adresave zyrtare, përpilimi i listës së fundit të vendbanimeve nga ASK me mbështetje edhe nga AKK, zhvillimi i ueb shërbimeve të nevojshme për konsumimin e të dhënave të nevojshme të adresave nga ARBK dhe ATK etj. Shfrytëzimi i adresave nga ana e Postes së Kosovës është shumë me rëndësi, me që puna ditore e Postës është e ndërlidhur me adresa. Në kuadër të këtij aktiviteti AKK ka ndërmarrë disa aktivitete si: përgatitja e memorandumit të bashkëpunimit, takime me zyrtarët e Postes rreth krijimit të zonave postare dhe shfrytëzimit të adresave nga ana e postës, unifikimi i kodave postare me vendbanime, krijimi i Zonave postare në formatin grafike (shape) në bashkëpunim me zyrtarët e Postes së Kosovës dhe futja e tyre në ; Kompania KEDS (kompania për shpërndarjen e energjisë elektrike) ka shtrirjen më të madhe të aktivitetit dhe puna e tyre është e ndërlidhur me adresa, AKK ka vlerësuar si palë shumë me rëndësi për unifikimin e përdorimit të adresave. AKK ka realizuar disa takime të nivelit menaxherial dhe teknik përkitazi me ndërlidhjen e adresave me sistemin e KEDS-it, ka ofruar të dhënat e adresave, ka ofruar mbështetje teknike të ndryshme përkitazi me këtë aktivitet etj. Është me rëndësi të ceket, se nëse ndërlidhja e Regjistrit Civil me regjistrin e Adresave realizohet me sukses, ndërlidhja me KEDS pastaj mund të bëhet në mënyrë automatike.

AKTIVITETE TJERA

Prezantimi në webinarin e organizuar nga EuroGeographics, Krijimi i Sistemit të Unifikuar të Adresave të Kosovës;

Përgatitja e dokumenteve të nevojshme për zhvillimin e modulit në për Certifikatën e Adresës takime me ekspertet e kompanisë mirëmbajtëse të sistemeve në AKK rreth modulit në fjale, testimi i funksionimit të këtij moduli, ndryshimet tjera në si: përmirësimin e (Activity log), shtimin e atributëve tek eksportimi i disa të dhënave, shtimi i llojit të Zonës së Qarkullimit Publik tek pjesa grafike e -it etj.;

Vlerësimi teknik i vendimeve të komunave për emërtimin dhe riemërtimin e zonave të qarkullimit publik; Monitorimi i funksionimit të -it, raportimi i problemeve dhe testimi i rregullimit të problemeve; Përpilimi i termave të referencës për projektin e BB-se për përgatitjen e strategjisë për informim publik; Vlerësimi i kandidatëve për përkthyes të Gjuhës An- gleze;

Kontrollimi i të dhënave të adresave përmes -it për komunat të cilat kanë përditësuar të dhënat; Përgatitja e të dhënave të adresave për palët e interesuara.

15. ZHVILLIMI I KAPACITETEVE PËR PËRGJITHËSIMIN E HARTAVE DIGJITALE TOPOGRAFIKE

Si institucion përgjegjës për mirëmbajtjen e regjistrave pronësor, kadastrë, gjeodezi, hartografi, sistem të adresave dhe për Infrastrukturën Kombëtare të Informacioneve Hapësinore (IKIH), Agjencia Kadastrale e Kosovës vit pas viti ka zhvilluar një varg produktesh që kanë ngritur cilësinë e shërbimeve ofruar institucioneve dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës. Si Autoriteti më i lartë për Hartografi në Republikën e Kosovës, AKK kishte marrë vendim për përpilimin e herëtës topografike, duke u bazuar në analizën dhe vlerësimin e hartave të vjetra dhe kërkesën për harta të tilla të reja. Në përgjigje të kërkesës zyrtare të Qeverisë të Republikës të Kosovës, Qeveria e Japonisë, respektivisht Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtarë (JICA) ka mbajtur një sërë takimesh me Agjencinë Kadastrale të Kosovës, për ta zhvilluar një plan të hollësishëm të zhvillimit të burimeve njerëzore për informacionet gjeohapësinore të Kosovës. Pas përfundimit me sukses të projektit “Zhvillimi i burimeve njerëzore për informatat gjeohapësinore të Kosovës” që ishte realizuar në vitin 2013 për 90% e territorit të Kosovës, dhe me pas pjesa tjetër e mbetur 10% ishte realizuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, bashkëpunimi mes AKK-së dhe JICA-së, ka vazhduar edhe gjatë viteve 2020-21 në ngritjen e kapaciteteve të eksperteve të AKK-së që në mënyrë të pavarur të bëjnë përgjithësimin e Hartës Digjitale Topografike në shkallë të ndryshme. Periudha e transferimit të teknologjisë dhe njohurive, ishte realizuar “online” nga tetori 2020 deri në mars 2021 (për shkak të Pandemisë Covid 19) dhe periudha tjetër ishte realizuar në objektet e AKK-së, në tetor të vitit 2021. Krijimi i hartës topografike digjitale 1:250.000, u realizua nga ekspertët vendor me përkrahjen profesionale dhe financiare të ofruar nga Qeveria e Japonisë JICA (Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar).

Bartja e njohurive dhe teknologjisë ka pas për qëllin ngritjen e kapaciteteve të AKK-së për:


- Krijimin e rregulloreve (krijimin e një modeli standard, ku si reference është marrë krijimi i hartave topografike ne rajon si dhe standardet që aplikohen ne Japoni).
- Përgatitjen e udhëzuesve për krijim të hartës në shkallë më të vogël.
- Krijimin e simboleve për shkallë te caktuar.
- Krijimin e nomenklaturës së fletëve të hartës në shkallë më të vogël.
- Krijimin e hartës topografike digjitale 1:250.000.
- Mirëmbajtjen e këtyre të dhënave.

Ekspertët nga Agjencia Kadastrale të Kosovës të cilët kanë marrë pjese ne transformim të teknologjisë kanë qenë ekspertët e GIS-it në AKK, z. Avni Rustemi dhe z. Amir Reçica.

15.1 PËRGJITHËSIMI I HARTËS TOPOGRAFIKE 1:250 000

Harta topografike gjithnjë ka pasur rol të rëndësishëm në shoqëri, pavarësisht që dikur ajo ishte vetëm në formën analoge ndërsa tani është edhe në formën digjitale. Harta topografike në shkallë 1:25000 quhet edhe harta bazike topografike, Nga kjo hartë me përgjithësimin hartografik të saj mund të përpi- lohen hartat tjera topografike në shkallë me të imtë se kjo. Përgjithësimi hartografik përfshin të gjitha ndryshimet gjatë procesit të një harte në shkallë më të vogël në harta më shkallë më të mëdha, respektivisht nga shkalla e hartës topografike digjitale 1:25.000 në shkallë 1:50.000, 1:100.000 ,1:250.000, dhe 1:500.000. Nga ky rocess është bërë konvertimi i të dhënave gjeohapësinore nga një niveli më i lartë i saktësisë tek një nivel më të ulët, krejt me qëllim që në fletën e hartës të përfshihet detaji me hapësirë më të madhe e cila thekson elementet më të

rëndësishëm të hartës, gjithnjë duke punuar sipas rregullores se krijuar për hartat topografike. Aktivitetet, gjate transferimit të teknologjisë dhe njohurive fillimisht është ber, përgatitja e të dhënave GIS nga baza e të dhënave të hartës topografike 1:25,000, strukturimi dhe përgjithësimi i veçorive për shkallë të caktuar, procesi i kontrollit të kualitetit sipas saktësisë dhe cilësisë, dhe krijimi i indeksit fletëve të hartave topografike me shkallë të ndryshme (1:50,000, 1:100,000, 1:250,000 dhe 1:500,000). Me pastaj procesi ka vazhduar me përgjithësimin dhe gjeneralizimin e të gjitha veçorive, qe ne rastin e krijimit të hartës topografike 1:250 000 është ber shkrirja e të gjitha gjeodatabazave (155) nga harta topografike 1:25,000 në një gjeodatabazave të vetme, dhe pastaj është ber përgjithësimi dhe krijimi i hartës topografike me shkallë më të vogël.



Rrjedha e punës së përgjithësimin hartografik

15.2 KRIJIMI, REDUKIMI DHE POZICIONIMI I SIMBOLEVE

Gjate transferimit të teknologjisë dhe njohurive është punuar rregullorja për krijimin dhe standardizimin e simboleve për shkallët me të vogël të hartave topografike, sipas modelit japonez. Sipas rregullores se krijuar për përgjithësim të hartave topografike janë reduktuar dhe pozicionuar të gjitha veçoritë, po ashtu janë reduktuar dhe pozicionuar edhe toponimet.


15.3 HARTA TOPOGRAFIKE 1:250 000

Harta topografike përbehet nga një seri të informacioneve në formë të shtresave siç janë: Kufijtë shtetëror dhe parqeve nacionale, pikat kontrolluese, objektet e transportit dhe trafikut, ndërtimet, hidrografia, shfrytëzimi i tokës, vegjetacioni, topografia, dhe toponimet-emërtimet. Pra hartë topografike është një paraqitje e relievit dhe elementeve shoqërore dhe natyrore të sipërfaqes së tokës të paraqitura në formë të simboleve dhe ngjyrave, të përcaktuar sipas rregullores për krijimin e hartave topografike. Falë gjithë këtyre informacioneve (simboleve dhe ngjyrave) shqipe hartat do të dallohen dhe të lexohen lehtë nga përdoruesi. Karakteristikat e hartës topografike 1:250 000, janë punuar me të dhënat e hartës topografike 1:250000 që është prodhuar nga incizimi aerofotogrametrik i vitit 2012-13, si dhe ishte verifikuar në terren gjatë vitit 2014.

15.4 REKOMANDIMET DHE PËRMBYLLJA E PROJEKTIT

Harta topografike me shkallë 1:250,000 rekomandohet të përditësohet pasi të jenë përditësuar të gjitha fletat e hartës të shkallës 1:25,000, në përjashtim mund të bëhet përditësimi i pjesshëm i lokacioneve, vetëm në ato raste ku janë ndërtuar objekte të rëndësishme siç janë: autostradat, hekurudhat, diga etj. Pas kontrollit të kualitetit i cili ishte gjithëpërfshirës, është mbajtur edhe një seminar përmbyllës lidhur me shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe përditësimin e hartave në shkallë më të vogël të Kosovës. Gjatë seminarit ekspertët e JICA-së prezantuan se si përdoren hartat topografike 1:25,000 dhe hartat në shkallë më të vogël në Japoni. Të dhënat e fituara gjatë transferimit të teknologjisë janë të paraqitura në Gjeoportalin shtetëror të Kosovës, përveç kësaj, për pjesëmarrësit janë shtypur paraprakisht kopje fizike të hartave topografike dhe u janë shpërndarë, si dhe parashihet ti shpërndahen të gjitha ministrive, agjencive

dhe komunave të Kosovës. AKK është duke bashkëpunuar me agjencitë evropiane të informacionit gjeohapësinor për publikimit dhe shpërn darjen e këtyre të dhënave.



Harta topografike 1:250.000

PËRDORUESIT KRYESOR TË HARTËS TOPOGRAFIKE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS JANË:

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (për planifikime hapësinor).

Forca e Sigurisë së Kosovës dhe Këshilli i Sigurisë së Kosovës (për siguri).

Agjencia e Menaxhimit Emergjent (për intervenime nga rreziqet nga zjarret, vërshimet përmytjet etj.)

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore (për studimi dhe riparimin e digave ekzistuese të Kosovës).

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (për krijimin e sistemit të integruar të të dhënave rreth asetëve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore dhe aktiviteteve sportive),

Agjencia e Statistikave të Kosovës (për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave).

*Ministria e Ekonomisë (për interkoneksionin e gazit)
Komunave të Kosovës (për planifikim dhe krijimin e hartës zonale dhe urbanizëm).*

Ambasada Amerikane (për studimin e fizibilitetit të Liqenit të Ujëmanit),

Departamenti i Gjeografisë dhe Gjeodezisë (punime shkencore dhe arsimore).

Kompanitë private (infrastrukturore dhe urbanizëm).

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (menagjimin e Minierave dhe gyrthyesit)

16. HARTA E PRONËSISË

Harta e pronësisë dhe gjeodeatabaza është një dokument i cili paraqet shtrirjen gjeografike të pronave sipas tipit të pronësisë duke u bazuar në parcelat kadastrale. Tipet e pronave të cilat gjenden në Regjistrin zyrtar të Pronave në Agjencinë Kadastrale të Kosovës janë:


- Pronë private;
- Pronë shtetërore dhe Pronë shoqërore

Kushtetuta e Republikës në paragrafin 1 të nenit 121 ka përcaktuar se :“Llojet e pronës rregullohen me ligj”. Gjithsesi nuk është hasur ndonjë ligj i veçantë në të cilin përcaktohet çështja e tipit të pronës. Nëse i referohemi strategjisë për të drejtat pronësore, përkatësisht pikës 1.3.1 “Sistemi i përgjithshëm i të drejtave pronësore”, paragrafi i fundit i kësaj pike cek tipet e pronave “Andaj mund të konkludohet që Kushtetuta në mënyrë të qartë i përmend llojet e pronës në vijim: pronën private, pronën publike, pronën shtetërore dhe pronën shoqërore”. Harta e Pronësisë synon që përmes analizave hartografike dhe statistikore të paraqet gjendjen aktuale të shtrirjes së pronave sipas tipit të tyre dhe fqinjësinë në mes tyre, në Republikën e Kosovës. Rëndësia e Hartës së Pronësisë, qëndron në atë se duke u bazuar në llojet e pronave, hartohen dokumente të rëndësishme të planifikimit hapësinorë në nivel nacional dhe lokal, siç janë:

- Plani Hapësinor i Kosovës, Harta Zonale e Kosovës,
- Plani Hapësinor për Zona të Veçanta, Plani Zhvillimor Komunal,
- Harta Zonale e Komunës dhe Plani Rregullues i Hollësishtëm.

Fillimisht një raport për Hartën e Pronësisë ishte përgatitur nga Instituti për Planifikim Hapësinor (IPH) në kuadër të MMPHI me të dhënat nga AKK. Pas rishikimit të këtij raporti nga ekspertët e AKK-së u konstatua se të dhënat e përdorura nga IPH ishin të viteve 2014-2015. Për këtë arsye në koordinim me IPH u vendos që AKK të përgatit nga fillimi raportin për Hartën e Pronësisë me të dhënat e fundit që disponon. Për të përgatitur raportin për Hartën e Pronësisë, janë krijuar hartat dhe tabelat në nivelin nacional dhe nivelin lokal për secilën komunë. Të dhënat të cilat janë përdorur për të krijuar “Hartën e Pronësisë” janë marrë nga dy regjistrat kryesor të Agjencisë Kadastrale të Kosovës të cilët janë duke përdoren për mirëmbajtjen e të dhënave kadastrale. Të dhënat mbi pronësinë janë nxjerr (ekstraktuar) nga pjesa tekstuale SIKTK-T (Sistemi i Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovës - Tekstual) ndërsa të dhënat gjeohapësinore (vektoriale) janë nxjerr (ekstraktuar) nga pjesa grafike SIKTK-Harta Kadastrale. Të gjitha këto të dhëna janë nxjerr (ekstraktuar) nga databazat përkatëse të këtyre dy sistemeve të përmendura më lartë. Të dhënat e nxjerra nga SIKTK-T janë eksportuar në “CSV file” drejtpërdrejt prej aplikacionit MS-SQL ndërsa të dhënat e nxjerra (ekstraktuara) nga SIKTK-Harta Kadastrale së pari janë thirr (lexuar direkt prej databazës përmes aplikacionit të GIS-it dhe më pas janë eksportuar në formatin “shapefile”. Pastaj këta dy regjistra janë bashkuar përmes aplikacionit të GIS-it sipas ID-së së parcelës, dhe sërish është eksportuar në “shapefile” si një regjistër i vetëm. Në këtë regjistër përfshihen të dhënat për gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Të dhënat grafike dhe tekstuale të cilat janë përdorur për krijimin e hartës së pronësisë përkojnë me muajin Shtator të vitit 2021.

16.1 METODOLOGJIA, ANALIZIMI I TË DHËNAVE GRAFIKE DHE FILTRIMI I TË DHËNAVE NË PROCESIN TOPOLOGJIK




Harta sipas mbivendosjeve (overlap) dhe boshllëqeve (gaps)

Për të fituar sipërfaqet sipas tipit të pronësisë, fillimisht është bërë analizimi dhe kontrolli i kualitetit të të dhënave grafike, që pastaj të krijohet harta me sipërfaqe sipas tipit të pronësisë dhe sipërfaqeve të mundshme të konfliktit grafikë, proces i cili nënkupton identifikimin e konfliktit grafik. Analizimi i të dhënave grafike ka kaluar në dy faza kryesore:

- Filtrimi i të dhënave në procesin e topologjisë.
- Klasifikimi dhe kalkulimi i sipërfaqeve të tipit të pronës.


Rregullat e topologjisë përcaktojnë marrëdhëniet e lejueshme hapësinore midis klasave, nënklasave dhe llojeve të ndryshme të veçorive. Në rastin e krijimit të hartës së tipit të pronësisë janë përdoruar dy rregulla të topologjisë: mbivendosjet (overlap) dhe boshllëqet (gaps). Mbivendosja (overlap) është rregull e topologjisë për t'u siguruar që asnjë poligon të mos ketë mbivendosje me një poligon tjetër. Boshllëqet (gaps) është një tjetër rregull i topologjisë për t'u siguruar që mos të ketë bosh-

llëqe brenda një sipërfaqeje. Në këtë rast këto dy rregulla janë aplikuar për identifikimin e konfliktit grafik dhe boshllëqeve mes sipërfaqes të shtresave të tipit të pronësisë.



Mbivendosje (overlap) 4.11 km²

Boshllëqe (gaps) 3.16 km²



Harta e të gjitha shtresave të fituara pas procesit të topologjisë

Pas klasifikimit të sipërfaqeve sipas tipit të pronës dhe procesit të topologjisë janë fituar shtresat:

- Sipas tipit të pronës;
- Mospërputhje mes të dhënave tekstuale dhe grafike;
- Sipërfaqe që mungon informacioni për pronësi;
- Zonë të komasacionit dhe
- Sipërfaqe me mbivendosje dhe boshllëqe.

Shtresat (Tipi & Tjera)	km2	%
Pronë shtetëror	14.68	0.13%
Pronë shoqërore	3977.62	36.47%
Pronë private	5532.26	50.73%
Mospërputhje mes tekstuales dhe grafikes	1081.63	9.92%
Mungon informacioni për tipin e pronës	259.90	2.38%
Komasacion	31.80	0.29%
Mbivendosje (overlap)	4.11	0.04%
Boshllëqe (gaps)	3.16	0.03%
Gjithsej	10905.17	100%

Tabela 12. Sipërfaqja në metra katror e shtresave të llojeve të pronës


Shpjegim për Shtresat (Tjera).

Mospërputhje mes tekstuales dhe grafikës (do të thotë parcelat në grafikë janë të pa azhurnuara sipas pjesës tekstuale, numri i parcelës në grafikë ndryshon nga ai në tekstuale, për këtë arsye nuk është bërë lidhja gjatë procesit të bashkimit të pjesës grafike me pjesën tekstuale, kjo ka ndodhur si pasoj e plaçkitjes të dosjeve kadastrale pas luftës së vitit 1999 nga Serbia). Mungon informacioni për pronësi (në tekstuale mungon tipin i pronësisë). Zonë e Komasonit (në hartën sipas tipit të pronës

mungon vetëm ajo pjesë e komasacionit e cila ka mospërputhje të numrit të parcelës mes tekstuales dhe grafikës). Mbivendosje (overlap) do të thotë, poligonet të cilat kanë mbivendosje njëri me tjetrin. Boshllëqe (gaps), hapësira të zbrazëta brenda sipërfaqeve (mungon pjesa grafike).

Baza e të dhënave sipas komunave

Pasi që janë fituar të dhënat vektor (GDB) është punuar Hartat e Pronësisë për të gjitha Komunitatet e Kosovës (38 komuna) sipas: Tipit të pronës, mospërputhjes mes tekstuales dhe grafikës, sipërfaqeve që mungon informacioni për tipin e pronës, zonave të komasacionit dhe sipërfaqeve me mbivendosje dhe boshllëqe.



Baza e të dhënave sipas komunave

17. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONE PUBLIKE

Gjatë vitit 2021 AKK-ja ka zhvilluar disa takime me institucione të ndryshme publike për qëllime dhe avancime të ndryshme për shërbime më të lehta dhe më të shpejta për ta. Një nga zhvillimet e fundit të këtij viti ka qenë ofrimi i mundësisë që Noterët të mund të shënojnë në SIKTK një shënim për aktet e tyre noteriale që kanë të bëjnë me pronat e paluajtshme. Ky shënim rrit sigurinë për paluajtshmëri duke pamundësuar që njësia e njëjtë kadastrale të jetë njëkohësisht pjesë e disa akteve noteriale. Njëkohësisht ky shënim mund të modifikohet nga ana e noterëve apo anulohet krejtësisht në rast se anulohet edhe akti juridik i tyre. Shënimi i noterëve mandej mund të trajtohet nga ana e zyrtarëve të ZKK-ve të cilët mund ta fshijnë shënimin në momentin që në sistem ekzekutohet akti juridik i cili është i shënuar në atë shënim nga noteri. Ky modul gjithashtu ofron mundësinë e ngarkimit të dokumenteve, në rastin konkret mund të ngarkohet akti notarial me të cilin lidhet shënimi për njësitë kadastrale pjesë e atij akti. Në procesin e hapjes së të dhënave për institucione të ndryshme të interesit, respektivisht ofrimin e qasjes në Sistemin e Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë, Agjencia Kadastrale e Kosovës ka ofruar qasje edhe për gejodetët e licencuar. Fillimisht janë realizuar trajnime nga ana e AKK-së për të gjithë gjeodetët e licencuar në grupe të ndara në platforma online. Nga kjo pritet të përfitojnë si gjeodetët e licencuar përmes lehtësimit të kryerjes së punëve të tyre, po ashtu edhe qytetarët e institucionet e Republikës së Kosovës përmes shkurtimit të kohës për kryerjen e punëve gjeodezike dhe përmes ngritjes së kualitetit të produkteve dhe shërbimeve kadastrale dhe pronësoro-juridike. Agjencia kadastrale e Kosovës edhe gjatë këtij viti ka bërë disa marrëveshje me institucione për shkëmbimin e të dhënave Kadastrale përmes web servise të zhvilluara në SIKTK-T. Institucionet të cilat veçse kanë filluar të konsumojnë shërbime janë: Agjencia Kosovare për inteligjence, Oda Përmbaruesve private,

Departamenti i tatimit në pronë, Bankat, Institucionet microfianciare, Administrata Tatimore e Kosovës, Agjencia Kosovare e Privatizimit, Oda e noterëve të Kosovës, Këshilli Prokurorial, Njësia për Inteligjencë financiare si dhe Policia e Kosovës. Departamenti i Tatimit në Pronë, Bankat dhe Institucionet Microfinanciare konsumojnë shërbimet tona përmes web serviseve, ndërsa institucionet tjera konsumojnë shërbimin përmes GUI aplikacionit. Për institucionet që marrin shërbim përmes GUI aplikacionit, AKK organizon trajnim për shfrytëzimin e tij, fillimisht në ambientin testues ku krijohen shfrytëzues sipas nevojës së institucionit për një periudhë të caktuar e më pastaj kjo lidhje ndërpritet dhe vazhdohet konsumimi i tyre në ambientin real. AKK në vazhdimësi bënë përkrahje të shfrytëzuesve të të gjitha institucioneve deri në përvetësimin e sistemit nga ana e tyre. Deri më tani përmes GUI aplikacionit tonë marrin shërbime rreth 180 shfrytëzues nga të gjitha institucionet e lartcekura . Ndërsa në proces për të filluar konsumimin e shërbimeve kadastrale përmes GUI aplikacionit nga sistemi real janë edhe 127 Gjeodetë privatë të Licencuar nga AKK-ja. Për të gjitha këto institucione janë krijuar raporte mujore të konsumimit të shërbimeve kadastrale si dhe janë përcjellë përmes zyrës së marketingut faturat për pagesë tek institucionet gjegjëse. Po ashtu edhe gjatë këtij viti Departamenti i Tatimit në Pronë me datën 30 Nëntor përmes web servisit të AKK-së ka konsumuar të gjitha të dhënat kadastrale me qëllim të faturimit të qytetareve për tatimin në pronë. Ndërsa AKK për nevoja të veta konsumon web shërbime nga ARBK, ARC dhe OJQ. Këto shërbime konsumohen përmes platformës së interoperabilitetit nga ASHI. Konsumimi i këtyre web shërbimeve ka ngritur në masë të madhe cilësinë e të dhënave kadastrale.

18. SKËMBIMI I TË DHËNAVE ME INSTITUCIONET E JASHTME

Agjencia kadastrale e Kosovës edhe gjatë këtij viti ka bërë disa marrëveshje me institucione për shkëmbimin e të dhënave Kadastrale përmes web servise të zhvilluara në SIKTK-T. Institucionet të cilat veçse kanë filluar të konsumojnë shërbime janë: Agjencia Kosovare për inteligjence, Oda Përmbaruesve private, Departamenti i tatimit në pronë, Bankat, Institucionet microfinanciare, Administrata Tatimore e Kosovës, Agjencia Kosovare e Privatizimit, Oda e noterëve të Kosovës, Këshilli Prokurorial, Njësia për Inteligjencë financiare si dhe Policia e Kosovës. Departamenti i Tatimit në Pronë, Bankat dhe Institucionet Microfinanciare konsumojnë shërbimet tona përmes web serviseve, ndërsa institucionet tjera konsumojnë shërbimin përmes GUI aplikacionit. Për institucionet që marrin shërbim përmes GUI aplikacionit, AKK organizon trajnim për shfrytëzimin e tij, fillimisht në ambientin testues ku krijohen shfrytëzues sipas nevojës së institucionit për një periudhë të caktuar e më pastaj kjo lidhje ndërpritet dhe vazhdohet konsumimi i tyre në ambientin real. AKK në vazhdimësi bënë përkrahje të shfrytëzuesve të të gjitha institucioneve deri në përvetësimin e sistemit nga ana e tyre. Deri më tani përmes GUI aplikacionit tonë marrin shërbime rreth 180 shfrytëzues nga të gjitha institucionet e lartcekura . Ndërsa në proces për të filluar konsumimin e shërbimeve kadastrale përmes GUI aplikacionit nga sistemi real janë edhe 127 Gjeodetë privatë të Licencuar nga AKK-ja. Për të gjitha këto institucione janë krijuar raporte mujore të konsumimit të shërbimeve kadastrale si dhe janë përcjellë përmes zyrës së marketingut faturat për pagesë tek institucionet gjegjëse. Po ashtu edhe gjatë këtij viti Departamenti i Tatimit në Pronë me datën 30 Nëntor përmes web servisit të AKK-së ka konsumuar të gjitha të dhënat kadastrale me qellim të faturimit të qytetareve për tatimin në pronë. Ndërsa AKK për nevoja të veta konsumon web shërbime nga ARBK, ARC dhe OJQ-të. Këto shërbime konsumohen përmes platformës së interoperabilitetit

nga ASHI. Konsumini i këtyre web shërbimeve ka ngritur në masë të madhe cilësinë e të dhënave kadastrale.

18.1 SHËRBIMET E OFRUARA ZYRAT KADASTRALE KMUNALE DHE AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS

Të dhënat kadastrale që ofron AKK, për shumë institucione të vendit janë të dhëna kyqe dhe shumë të rëndësishme nga të cilat mvaret edhe realizimi i objektivave të tyre. Gjatë vitit 2021, krahasuar me vitin 2020 numri i kërkesave u rrit ndjeshëm dhe arriti në gjithsejtë 615. Kërkesat e parashtruara nga institucionet për të dhëna kadastrale janë të listuara në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Institucioni	Nr. i kërkesave
1	Agjencia e Kosovës për Inteligjencë	17
2	Agjencia Kundër Korrupsionit	9
3	Agjencia Kosovare e Privatizimit	11
4	Administrata Tatimore e Kosovës	163
5	Azhurnime në SIKTK - Komunitat Veriore	96
6	Certifikata për komunat veriore	325
7	Certifikata që nuk posedon pronë	10
8	Departamenti i Hetimeve Tatimore	3
9	Gjykata Themelore Mitrovicë	11
10	Gjykata Themelore Pejë	1
11	Gjykata Themelore Prishtinë	5

12	Gjykata Themelore Podgoricë	2
13	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	2
14	Azhurnime në SIKTK - Komisioni për RIK	8
15	Përmbaues Privat	9
16	Policia e Kosovës	93
17	Prokuroria Themelore Ferizaj	1
18	Prokuroria Speciale	1
19	Agjencia Pyjore e Kosovës	3
20	Ministria e Kulturës	1
21	Ministria e Drejtësisë	3
22	Fakulteti Teknik	1
Gjithsej		775

Tabela 13. Statistika rreth kërkesave të përashtruar nga institucione publike

19. KOORDINIMI I PROJEKTEVE, BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Në kuadër të Agjencisë Kadastrale të Kosovës ekziston edhe Njësia për Implementimin e Projekteve, e cila si pasuese e Zyrës për Koordinimin e Projekteve, siguron që të gjitha aktivitetet e projektit të jenë në përputhje me ligjet vendore dhe kërkesat, procedurat dhe rregullat e vetë donatorëve apo përkrahësve si Banka Botërore, JICA, Autoriteti Norvegjez për Kadastër dhe Hartografi Kartverket dhe Qeveria Holandeze. Sa i përket projekteve kryesore aktuale të cilat zhvillohen në kuadër të Agjencisë Kadastrale të Kosovës me përkrahjen e organizmave ndërkombëtare janë: Projekti për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme dhe Infrastrukturës Gjeohapësinore (REGIP), projekti përkrahës i Qeverisë Norvegjeze, projekti regional SPATIAL II i përkrahur nga Qeveria Holandeze si dhe projekti për gjeneralizimin e hartave topografike me shkallë të vogël, përkrahur nga JICA Japoneze.

19.1 PROJEKTI PËR REGJISTRIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME DHE INFRASTRUKTURËS GJEHAPËSINORE (REGIP)

Projekti për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme dhe Infrastrukturës Gjeohapësinore (REGIP) është i mbështetur nga Banka Botërore në formë kredie në vlerë prej 14.600.000 Euro. Projekti do të implementohet në periudhën 5 vjeçare dhe është bërë efektiv me 02 shtator 2020. Deri më tani projekti nuk ka mundur të realizojë shumë aktivitete. Gjendja e pandemisë Covid 19 gjithashtu ka ngadalësuar ritmin e progresit të aktiviteteve. Për të diskutuar aktivitetet e projektit REGIP, me datë 14 Korrik 2021, AKK ka mbajtur një takim pune me Ministrin e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës z. Liburn Aliu dhe Shefen e kabinetit të Ministrit z-njës Rineta Jashari. Në takim përmes diskutimeve interaktive janë prezantuar projektet, rezultatet e pritura nga implementimi i tyre dhe

sfidat eventuale me të cilat implementimi i projekteve mund të ballafaqohet. Si rekomandim i përgjithshëm nga takimi, z. Aliu propozoi gjithëpërfshirje sa më të madhe profesionale para fillimit të implementimit të projekteve kapitale siç janë Rindërtimi i informacioneve kadastrale, Sistemi i unifikuar i adresave dhe Rilevimi aerofotogrametrik i territorit të Republikës së Kosovës. Për këtë, u propozua që në muajin shtator të mbahet një punëtori gjithëpërfshirëse ku do të diskutohej mbi këto projekte dhe ku do të kërkohej jo vetëm përfshirja por edhe kontributi i profesionistëve me qëllim të implementimit sa më të suksesshëm të projekteve dhe që përfitimi i qytetarëve dhe institucioneve të Republikës së Kosovës të jetë sa më i madh. Me me datë 27 Shtator 2021 është mbajtur tryeza e punës për rindërtimin e informacioneve kadastrale me profesionistë të fushës dhe akterë tjerë institucional. Kjo tryezë si konkluzion ka nxjerrë nevojën e plotësimit të kornizës ligjore para se të fillohet me projekt. Këto plotësime dhe ndryshime ligjore janë parapara në Ligjin për Kadastër të Pronës së Paluajtshme i cili është planifikuar të miratohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës gjatë muajit dhjetor 2021. AKK gjithashtu gjatë tremujorit të fundit të vitit 2021, ka pasur takime të rregullta me Kabinetin e Ministrit të MMPHI-së, ku janë diskutuar benefitet, progresi i aktiviteteve të projektit dhe tejkalimi sfidave eventuale të projektit. AKK ka pritur edhe delegacionin nga ekipi i Bankës Botërore, respektivisht Udhëheqësi i Ekipit z. Paul Prettitore dhe bashkë udhëheqësi i këtij ekipi z. Caleb Travis Johnson të cilët kanë qëndruar në vizitë katër ditore në Agjencinë Kadastrale të Kosovës (AKK) në periudhën 30 nëntor – 03 dhjetor 2021. Më 03 dhjetor delegacionit ju është bashkëngjitur edhe Zj. Lindi- ta Lepaja nga Zyra e Bankës Botërore në Prishtinë. Gjatë kësaj vizite AKK ka bërë një pasqyrim të gjendjes faktike në lidhje me aktivitetet e parapara në kuadër të projekti REGIP, me theks të veçantë aktivitetet kapitale si Rindërtimi i Informacioneve Kadastrale, Aerofotografimi i Territorit të Republikës së Kosovës, Implementimi i Sistemit të Unifikuar të Adresave,

Ri-inxhin- jerimi i Zyrrave Kadastrale Komunale etj., si dhe janë diskutuar planet dinamike për implementim të këtyre projekteve, duke mos lënë anash as sfidat me të cilat janë duke u ballafaquar ekspertët e AKK-së në këtë fazë fillestare të implementimit të aktiviteteve.

Progresi aktual sipas komponentëve:

Komponenti A. Politikat, Mbështetja Ligjore dhe Institucionale: Qëllimi i kësaj komponente është të ofrojë mbështetje politike, ligjore dhe institucionale për Agjencinë Kadastrale të Kosovës. Kjo komponentë do të financojë ofrimin e mallrave dhe shërbimeve për: (a) zhvillimin e një strategjie të përditësuar të AKK- së dhe planit të biznesit për të informuar dhe udhëzuar zhvillimin e ardhshëm të të dhënave dhe shërbimeve kadastrale dhe gjeohapësinore në Kosovë; dhe (b) zhvillimin e mëtejshëm të Ligjit të ri të Kadastrit. Në kuadër të kësaj komponente është zhvilluar plani strategjik dhe plani i biznesit/veprimit 2021-2025. Mbështetja për AKK-në rreth hartimit të kornizës ligjore sipas planit të veprimit legjislativ dhe studimi i tregut të tokës në Kosovë janë parapara për tu implementuar në vitet e ardhshme.

Komponenti B. Modernizimi i Kadastrit : Objektivi i këtij komponenti është vazhdimi i modernizimit të kadastrit në Kosovë, e cila filloi në kuadër të projektit paraprak për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme në Kadastër (RECAP). Ky komponent do të financojë sigurimin e mallrave dhe shërbimeve për: RIK në 140 Zona Kadastrale;

- përmirësimi i cilësisë së të dhënave kadastrale;
- zhvillimin e kadastrit të përçojave;
- zhvillimin e regjistrimit të ndërtesave,
- renovimin dhe ri-inzhinjerimin e ZKK.

Rindërtimi i informacioneve kadastrale në 120 Zona kadastrale.

Ky është projekti kryesor kapital në kuadër të REGIP, dhe për të pasur benefite maksimale për qytetarët në Zonat Kadastrale të parapara në këtë projekt, si dhe për të pasur gjithë përfshirje të akterëve të involvuar në fushën e kadastrit dhe administrimit të tokës në Republikën e Kosovës, me datë 27 Shtator 2021 është mbajtur tryeza e punës me profesionistë të fushës dhe akterë tjerë institucional, e cila si konkluzion ka nxjerrë nevojën e plotësimit të kornizës ligjore para se të fillohet me këtë projekt. Këto plotësime dhe ndryshime ligjore janë paraparë në Ligjin për Kadastër të Pronës së Paluajtshme i cili është planifikuar të miratohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës gjatë muajit dhjetor 2021.

Shërbimet për korrektimin e të dhënave në Sistemin e Informacionit Kadastral të Tokës në Kosovë – SIKTK

Është formuar grupi punues për të hartuar specifikat teknike nga AKK, i cili ka nxjerrë në pah plotësimin e Udhëzimit Administrativ . Gjithashtu do të implementohet një pilot projekt në dy Zona Kadastrale i cili do të nxjerrë në pah procedurat dhe metodologjinë më të mirë për të realizuar korrektimin e të dhënave në SIKTK për gjithë Republikën e Kosovës.

Implementimi i Planit të Veprimit për Informim Publik

Janë zhvilluar procedurat e prokurimit për angazhimin e Kompanisë Konsulente për hartimin e Planit të Veprimit për Informim Publik. Posa të hartohet ky plan i veprimit, i njëjti do të implementohet gjatë viteve të ardhshme sipas këtij plani.

Komponenti C. Teknologjia e Informacionit dhe Infrastruktura Gjeohapësinore:

Objektivi i këtij komponenti është të bëjë investime në sistemet e IT-së dhe investime për të dhënat gjeohapësinore për tregun e tokës dhe pronës në Republikën e Kosovës dhe do të mbështesë zbatimin e strategjive të AKK- së për IT dhe Infrastruktura Kombëtare të Informacioneve Hapësinore (IKIH). Ky komponent do të financojë ofrimin e mallrave dhe shërbimeve për: (a) përmirësimin e Sistemit të Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë në drejtim të Arkitekturës së Orientuar në Shërbime (SIKTK-AOSH); (b) Arkivin digjital të AKK-së; (c) Zbatimin e strategjisë së IT-së për AKK-në; (d) investimet në IKIH (ang. NSDI); dhe (e) Zhvillimi i mëtutjeshëm i rrjetit shtetëror gjeodezik të GPS-it, KOPOS.

Rilevimi aerofotogrametrik i territorit të Republikës së Kosovës; Është formuar grupi punues i cili ka hartuar draftin e specifikave teknike të cilat janë në procedurë të komentimit dhe aprovimit nga Banka Botërore për të filluar me procedura të prokurimit.

Mbështetja për Infrastrukturën Kombëtare të Informacioneve Hapësinore

Krahas projektligjit për Infrastrukturën Kombëtare të Informacioneve Hapësinore (IKIH), i cili ka kaluar leximin e parë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, janë hartuar Termat e Referencës për angazhimin e një konsulenti profesional për të përditësuar dhe plotësuar Strategjinë për IKIH, të cilat do të diskutohen me Bankën Botërore për aprovim të tyre për të filluar procedurat e prokurimit për angazhimin e këtij konsulenti.

Janë hartuar Specifikat Teknike dhe është duke u përgatitur dosja e tenderit për tu aprovuar nga Banka Botërore për fillimin e procedurave të prokurimit për angazhimin e Kompanisë e cila do të bëjë përditësimin e këtij sistemi sipas specifikave të parapara.

Kompletimi i Sistemit të Adresave

Aktualisht është duke u finalizuar drafti i Specifikave Teknike për vendosjen e tabelave me adresa të rrugëve dhe numra të hyrjeve të objekteve, si dhe specifikat teknike për azhurnimin e segmenteve të rrugëve në bazën e të dhënave të Sistemit të Adresave. Zhvillimi i Webfaqes së Agjencisë Kadastrale të Kosovës Projekti është në fazën e prokurimit për përzgjedhjen e Kompanisë implementuese për zhvillimin e kësaj webfaqeje.

Komponenti D. Menaxhimi i Projektit, Ndërtimi i Kapaciteteve, Informimi Publik dhe Monitorimi dhe Vlerësimi : Qëllimi i këtij komponenti është të sigurojë zbatimin e plotë në afat kohor të Projektit. Ky Komponent do të financojë ofrimin e mallrave dhe shërbimeve për: (a) njësinë e zbatimit të projektit (PIU) dhe koordinimin e donatorëve; (b) monitorimin dhe vlerësimin; (c) anketat e kënaqshmërisë së qytetarëve me shërbimet kadastrale, (d) Informimi i publikut dhe mekanizmi i dëmshpërblimit (GRM);

Njësia e Implementimit të Projektit dhe Koordinimi i Donatorëve

Në kuadër të kësaj komponente është angazhuar konsulenti për prokurim (60 ditë pune për një vit). Në fillim të dhjetorit 2021 janë angazhuar specialistët për IT dhe për Infrastrukturë të Informacioneve Hapësinore (IKIH). Janë zhvilluar procedurat e përzgjedhjes së specialistëve për Kadastër dhe Monitorim dhe

Vlerësim të cilët pritet të fillojnë angazhimin e tyre kontraktual nga fillimi i Janarit 2022. Është në procedurë të prokurimit (për herë të dytë) përzgjedhja e Specialistit të Prokurimit dhe përzgjedhja e Specialistit Ligjor dhe përkthyes i gjuhës angleze.

Sistemi operacional për monitorim dhe vlerësim të projektit REGIP

Është në procedurë të prokurimit angazhimi i kompanisë konsulente për zhvillimin e metodologjisë së sistemit për Monitorim dhe Vlerësim të indikatorëve të paraparë të projektit REGIP.

Hulumtimet (Sondazhet) për Kënaqshmërinë e Klientëve

Është në procedurë të prokurimit angazhimi i kompanisë konsulente për hulumtimin (sondazhin) e parë të kënaqshmërisë së klientëve me shërbimet kadastrale.

Sfida kryesore e projektit ishte alokimi jo i mjaftueshëm i mjeteve buxhetore tek kategoria e mallërve dhe shërbimeve në pjesën e parë të vitit nga Ministria e Financave sipas kërkesave të projektit.

19.2 PROJEKTI PËRKRAHËS I QEVERISË NORVEGJEZE

Qeveria e Norvegjisë përmes Aurotitetit për Kadastër dhe Hartografi - Statens kartverk për shumë vite ka përkrahur Agjencinë Kadastrale të Kosovës për zhvillimin e kadastrit dhe Administrimit të Tokës në Republikën e Kosovës. Marrëveshja e Grantit aktual me Agjencinë Kadastrale të Kosovës është nënshkruar me 7 Janar 2018 dhe ka qenë e planifikuar të përfundojë me 30 Tetor 2020, por për shkak të shtyerjes së implemen timit të disa aktiviteteve nga situata e pandemisë Covid 19, në shtator 2020 është nënshkruar aneks marrëveshja për shtyerjen e afatit të implementimit të projektit deri më 31 dhjetor 2021. Objektivi i përgjithshëm i projektit është të përcjellë, kompletojë, zgjerojë dhe përmirësojë aktivitetet nga projektet e mëparshme

të Statens kartverk me Agjencinë Kadastrale të Kosovës.

Aktivitetet kryesore të planifikuara për periudhën e mbetur të implementimit të projektit janë:

- Sistemi i Adresave-Vendosja e tabelave me numrat e hyrjeve të objekteve në 6 Komuna (Malishevë, Klinë, Ferizaj, Obiliq, Kamenicë dhe Viti)
- Plotësimi i bazës së dhënave grafike në SIKTK
- Zgjerimi i regjistrit të pronës dhe regjistrit të adresave në tri komunat në Veri të vendit ; Ngritja e kapaciteteve të AKK-së;
- Përkrahje në hartimin e specifikave teknike për rrjetin e nivelimit në Republikën e Kosovës;

Aktivitetet e realizuara në kuadër të projektit përkrahës të Qeverisë Norvegjeze për vitin 2021 janë si vijon:

- Është përfunduar projekti për vendosjen e tabelave me adresat e numrave të hyrjeve në Komunat Malishevë, Klinë, Ferizaj, Obiliq, Kamenicë dhe Viti (shih kapitullin për Sistemin e Adresave);
- Është përfunduar projekti i migrimit dhe konvertimit të dhënave grafike në hartën kadastrale për Komunën e Prishtinës (shih kapitullin për migrimin dhe konvertimin e të dhënave në hartën kadastrale);
- Për përkrahje profesionale të AKK-së, janë angazhuar dy ekspertë për kadastër për periudhën nëntor 2020 –dhjetor 2021;
- Janë hartuar drafti fillestar i Specifikave Teknike për rrjetin e nivelimit në Republikën e Kosovës;

Projekti ka bërë të ditur se fondet për zgjerimin e regjistrit të pronës dhe regjistrit të adresave në tri komunat në veri të vendit do të shfrytëzohen gjatë vitit 2022.

19.3 PROJEKTI SPATIAL II I PËRKRAHUR NGA QEVERIA HOLANDEZE

Projekti për ngritjen e qasjes profesionale në informacione për Tokën (SPATIAL II) në rajonin e Ballkanit Perëndimor është pjesë e programit të para-anëtarësimit MATRA. MATRA është një program i madh i drejtuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Holandës, që synon ofrimin e mbështetjes për vendet e rajonit të Evropës Juglindore me perspektivat e pranimit në BE. Objektivi i përgjithshëm i MATRA është avancimi i një demokracie pluraliste, bazuar në shtetin e së drejtës, inkurajimi i dialogut midis qeverisë dhe shoqërisë civile, ndërtimi i kapaciteteve dhe forcimi i institucioneve të shoqërisë civile dhe qeverisë, si dhe forcimi i marrëdhënieve dypalëshe.

Projekti SPATIAL II ka për qëllim forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit profesional dhe qasjen në informacion në lidhje me tokën në Ballkanin Perëndimor, me qëllim që t'i sigurojë shoqërisë një informacion të besueshëm në lidhje me tokën për mirëqenien sociale dhe ekonomike. Projekti implementohet në periudhën 2020-2022 me përkrahje profesionale nga ekspertët e Autoritetit Holandez për kadastër dhe hartografi (Kadaster).

Aktivitetet e planifikuara të projektit janë:

Punëtoritë (workshopet) profesionale në Ballkanin perëndimor
Vizita studimore në Holandë dhe Konsulencë profesionale nga ekspertët e Kadaster për Me naxhimi i projektit.

Aktivitetet e projektit të planifikuara për vitin 2021, për shkak të situatës me pandeminë Covid 19, kryesisht janë kryer online. Aktivitetet e realizuara gjatë këtij viti janë:

Me datë 15 Tetor 2021 në Agjencinë Kadastrale të Kosovës është mbajtur një takim bilateral me ekspertët nga Autoriteti Holandez për Kadastër dhe Hartografi z Haico vd Vegt dhe z. Dorus

Kruse. Qëllimi i këtij takimi ishte të identifikohen fushat se ku do të duhej të fokusohesh për krahja për AKK-në. Si pika të interesit u veçua për krahja në fushën e infrastrukturës kombëtare për in- formacione hapësinore në Republikën e Kosovës, pastaj për krahje në ngritjen e kualitetit të të dhënave kadastrale dhe në avancim të planifikimit në fushën e përfitimeve nga produktet dhe shërbimet të cilat Agjencia Kadastrale e Kosovës ua ofron palëve të interesit. Është bërë shkëmbimi i përvojave profesionale midis Holandës dhe shteteve të Ballkanit Perëndimor lidhur me shërbimet dhe produktet elektronike. Kjo është orga- nizuar në tre (3) sesione online:

- **Sesioni i parë (02.11.2021)** i është dedikuar për të krijuar skenën dhe për të marrë një prezantim të përgjithshëm në lidhje me zhvillimin e shërbimeve elektronike dhe në veçanti politikën dhe kornizën themelore lig- jore të e-qeverisjes.
- **Sesioni i dytë (10.11.2021)** ka shtjelluar menaxhimin shumë kanalësh të shërbimeve dhe produkteve elektronike. Është thelbësore që shërbimet dhe produktet elektronike të përshtaten me nevojat e grupeve të ndryshme të klientëve për t'i adoptuar ato. Përdorimi i shërbimeve elektronike përcakton në një masë të madhe suksesin pozitiv (efikasitet më i mirë, shërbime më të shpejta etj.). Gjithashtu janë shpjeguar disa shërbime elektronike dhe produkte të zhvilluara për qytetarët.
- **Sesioni i tretë (17.11.2021)** është fokusuar në shër- bimet dhe produktet elektronike të zhvilluara për përdoruesit profesionistë si noteritë. Shërbimet elek- tronike luajnë një rol të rëndësishëm në optimizimin e proceseve të punës së kadastrit dhe noterëve, si dhe shkurton kohën e nevojshme për regjistrimin e transaksioneve.

19.4 PROJEKTI PËRKRAHËS I QEVERISË JAPONEZE

Në vazhden e përkrahjes së Qeverisë Japoneze nëpërmjet Agjencisë Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA) për Agjencinë Kadastrale të Kosovës është implementuar projekti “Zhvillimi i kapaciteteve për gjeneralizimin hartografik të hartave topografike digjitale në Kosovë”. Ky projekt ka për qëllim krijimin e kapaciteteve për krijimin e hartave topografike me shkallë të vogël 1:50,000, 1:100,000, 1:250,000 dhe 1:500,000. Projekti ka qenë i paraparë të përfundojë gjatë vitit 2020, por për shkak të situatës me pandeminë Covid 19, është shtyer afati i implementimit të projektit deri më 31 dhjetor 2021. Gjatë vitit 2021 është finalizuar projekti “Zhvillimi i kapaciteteve për gjeneralizimin hartografik të hartave topografike digjitale në Kosovë”. Aktivitetet e realizuara gjatë këtij viti janë:

- Janë zhvilluar trajnimet për ngritjen e kapaciteteve brenda AKK-së për krijimin e hartave topografike me shkallë të vogël;
- Është finalizuar gjeneralizimi i hartës topografike 1:250,000 (shih kapitullin për Hartën Topografike 1:250,000);
- Me datë 22 tetor 2021, në Hotel “Sirius” në Prishtinë, nën organizimin e JICA-s dhe me pjesëmarrjen e palëve të interesit është mbajtur tryeza e punës për përmbylljen e projektit me titull “Zhvillimi i kapaciteteve për gjeneralizimin hartografik të hartave topografike digjitale në Kosovë”.

Në këtë tryezë përmes debatëve interaktive është trajtuar kualiteti i hartës topografike 1:250,000, veçoritë e saja, benefitet nga përdorimi i hartës topografike, sfidat me të cilat u përballën ekspertët gjatë gjeneralizimit të hartës topografike si dhe u diskutua mbi hapat para në fushën e infrastrukturës kombëtare të informacioneve gjeohapësinore dhe në fushën e hartografisë.

19.5 PJESËMARRJA E AKK-SË NË KONFERENCËN E EUROGEOGRAPHICS

EuroGeographics është një organizatë e pavarur ndërkombëtare jofitimprurëse që përfaqëson autoritetet kombëtare të hartave, kadastrave dhe regjistrimit të tokës në Evropë dhe mbledh 61 agjenci kombëtare të hartave dhe kadastrave nga 46 vende në të gjithë Evropën. Agjencia Kadastrale e Kosovës është njëra nga Institucionet e para të Republikës së Kosovës që është bërë anëtare e rregullt e një organizate Evropiane qysh në vitin 2003, siç është orga- nizata jofitimprurëse e shteteve Euro- piane “Eurogeograph- ics”. Anëtarësimi i AKK-së ka ndodhur gjatë Konferencës së Asamblesë Gjenerale të Eurogeographics e mbajtur në Stam- boll, Turqi në periudhën 05-08 Tetor 2003. AKK në periudha të ndryshme nënshkruan marrëveshje e li- cencimit (Framework Licence Agreement) për mbrojtjen dhe shfrytëzimin e informa- cionit të AKK-së kur ato përfshihen në produktet dhe shërbi- met e Eurogeographics. AKK-ja gjatë kësaj periudhe ka tentuar të marr pjesë rregullisht në konfer- encat e Asambleve Gjenerale të Eurogeographics, si shtet i barabartë, për të kontribuar në punimet e asamblesë si dhe për të shkëmbyer njohuritë dhe përvojat me partnerë dhe organizatat simotra në shtetet e Europës. Me 16 Nëntor 2011 një delegacion i Agjencisë Kadastrale të Kosovës i përbërë nga u.d Drejtori i Drejtorisë për Kadastër z. Korab Ahmetaj dhe eksperti i Har- tografisë në AKK z. Avni Rustemi, ka marrë pjesë në takimin teknik të prodhuesve të të dhënave gjeohapësinore për Hartën Euro Regjionale e cila është duke u prodhuar dhe mirëmbajtur në kuadër të Euro- geographics-it. Qëllimi i këtij takimi teknik të ofruesve të të dhënave gjeohapësinore për hartën evropiane ishte identi- fikimi i të dhënave që mund të pasurojnë hartën evropiane ndërsa delegacioni i AKK-së pos që prezantoi hartën e saj të re topografike 1:250.000, këtë produkt ia bashkëngjiti vargut të produkteve gjeohapësinore të Republikës së Kosovës të paraqi- tura në Hartën Euro Regjionale.

20. PËRKRAHJE PROFESIONALE, LIGJORE DHE TEKNIKE

Përkrahja profesionale kadastrale

Nga përditshmëria e punëve dhe aktiviteteve që zhvillojnë Zyret Kadastrale Komunale shpesh hasin në vështirësi/paqartësi teknike e ligjore në punët e tyre. Për zgjidhjen e tyre ata marrin përkrahje të vazhdueshme nga ekspertët e Agjencisë Kadastrale të Kosovës. Gjatë dy viteve të fundit numri i personave që kanë kërkuar përkrahje nga AKK-ja është rritur dukshëm kjo për arsye se edhe numri i përdoruesve të jashtëm është rritur. Moduli i regjistrimit online të hipotekave ka rezultuar me kërkesa të mëdha për përkrahje nga ana e bankave dhe institucioneve mikrofinanciare. Gjithashtu volumin e kërkesave për përkrahje ky modul e ka rritur edhe nga ana e zyrtarëve të ZKK-ve. Forma, mënyra dhe kuptimi i rrjedhës së punës për regjistrimin, modifikimin dhe fshirjen e hipotekave kanë qenë disa nga kërkesat e zakonshme nga ana e të dyja palëve. Kërkesa për përkrahje kanë pasur edhe institucionet tjera të cilave iu është ofruar qasje në SIKTK nëpërmjet moduleve online si nga ana e Përmbauesve Privat, Noterëve, ATK-së, Gjeodetëve të licencuar, etj.

Përkrahja e përdoruesve të Sistemeve dhe Teknologjisë së Informatikës (SI/TI)

Gjatë vitit 2021 përdoruesit e ZKK-ve dhe përdoruesit e AKK-së janë përkrahë në mënyrë të vazhdueshme nga ana e DTI-së duke përfshirë këtu:

- Krijimin dhe konfigurimin e 38 shfrytëzues të rinj për ZKK;
- Janë riaktivizuar 6 shfrytëzues për ZKK ndërsa janë deaktivizuar 12 të tjerë;
- Regjistrimi dhe Riregjistrimi i kompjuterëve në domain

IPRR.KS dhe konfigurim i IP adresave në PC-të e ZKK-ve ose ndërrimi i IP adresës në rast konflikti në mes kompjuterëve (kur dy PC marrin të njëjtën IP) - 42 PC për ZKK.

- Resetimin e password-ve – 128 përdorues të ZKK-ve dhe AKK-së;
- Zhbllokimin e password-ve – 150 përdorues të ZKK-ve dhe AKK-së;
- Resetimin e emaila-ve qeveritar – 124 përdorues të AKK-së
- Është bërë instalimi i 79 printer-ve përmes remote desktop, qasje në printer, mapim i printerit dhe bërja share edhe për shfrytëzuesit e PC-ve tjerë të të njëjtës Komunë.
- Është bërë instalimi/riinstalim i 18 skanerëve përmes remote desktop në kompjuterët e ZKK-ve;
- Instalimin e browserit Google Chrome verzioni 64 – 15 përdorues;
- Përkrahje përmes telefonit se si të qasen në PC ose në aplikacione- 28 përdorues të ZKK-ve;
- Krijim i folderit Skanimi në kompjuterin e ZKK-së përkatëse , bërja share, qasje e shfrytëzuesve të PC-ve të tjera dhe mapimi i folderit Skanimi në desktopin e secilës PC – 33 përdorues të ZKK-ve;
- Janë kopjuar shënimet në CD – 44 përdorues të AKK-së.

21. ADMINISTRIMI INFRASTRUKTURËS SË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT (TI)

Stafi i DTI-së respektivisht sektori për menaxhimin e infrastrukturës së TI-së, menaxhon, administron dhe monitoron në baza ditore infrastrukturën në qendrën e të dhënave primare dhe në qendrën sekondare (DRC), ndërmerr të gjitha hapat e nevojshëm profesional për të siguruar shërbime të pandërprera për të gjithë përdoruesit (users) e regjistruar në domenin kompjuterik (domain) të AKK-së si dhe për ata të internetit që shfrytëzojnë shërbime të hostuara në qendrën e saj të të dhënave. Gjithashtu administron sigurinë e sistemit të TI-së në të gjitha nivelet dhe për të gjithë përdoruesit e regjistruar në domenin e AKK-së. Duke u bazuar në detyrat dhe objektivat, sektori i infrastrukturës gjatë vitit 2021 përveç detyrave rutinë të administrimit, menaxhimit dhe monitorimit të sistemit ka ndërmarrë edhe një sërë hapash për ngritjen e nivelit të sigurisë, automatizimin e proceseve dhe furnizim me PC për të gjithë punëtorët e AKK-së. Aktivitetet kryesore nga stafi i TI-së për këtë objektiv gjatë vitit 2021 përshkruhen në vijim.

Ngritja e nivelit të sigurisë – Auditimi dhe menaxhimi i aseteve të TI-së

Për të ngritur nivelin e sigurinë të Sistemeve të Informacionit dhe për të qenë në pajtueshmëri me standarde më të larta të sigurisë, gjithashtu duke i ndjekur praktikatat më të mira për auditim, menaxhim dhe monitorim të teknologjisë së informacionit, Drejtorati i TI-së në AKK ka bërë implementimin e softuerëve të auditimit dhe menaxhimit “Manage Engine ADAudit Plus” dhe “Manage Engine Asset Explorer. Me implementimin dhe konfigurimin e softuerit Manage Engine ADAudit Plus është mundur:

- Auditimi dhe gjurmimi i të gjitha ndryshimeve që ndodhin në Active Directory duke përfshirë monitorimin e AD, auditimin e përdoruesve të thjesht si dhe Administratorëve të TI-së. D.m.th auditohen përdoruesit e thjesht dhe Administratorët e TI-së për çdo ndryshim dhe intervenim në sistem me principin “Kush, Ku, Kur dhe Çka”.
- Bëhet auditimi i File Serverit duke monitoruar dhe njoftuar Administratorët e TI-së për çdo ndërhyrje, ndryshim që ndodh në File Server. Gjithashtu për skedar të caktuar bëhet auditimi dhe gjurmimi i File-ve, duke audituar çdo file nëse është i hapur, është lexuar apo është fshirë, me principin “Kush, Ku, Kur dhe Çka”.
- Bëhet auditimi dhe monitorimi i Windows Serverëve dhe Stacioneve Punuese, duke monitoruar pajisjet periferike dhe USB portet për ndonjë rrjedhje të mundshme të informacionit.

Implementimi dhe konfigurimi i këtij softuer ka ngritë në masë të madhe sigurinë duke parandaluar rrjedhjen e informacioneve dhe duke qenë në pajtueshmëri me praktikën dhe standardet më të mira të TI-së.

Softueri tjerët i implementuar dhe konfiguruar është Manag Engine Asset Explorer, i cili mundëson menaxhimin e Aseteve të TI-së.

ManageEngine AssetExplorer është softuer i bazuar në ueb platformë i cili bënë menaxhimin e Aseteve të TI-së që ndihmon në monitorim dhe menaxhim të aseteteve në rrjet duke filluar nga faza e planifikimit deri në fazën e asgjësimit. Ky softuer bënë zbulimin e të gjitha aseteteve të TI-së të cilat janë pjesë e rrjetit të AKK duke ofruar menaxhim të aseteteve të harduerit dhe softuerit dhe duke ofruar menaxhimin e blerjeve dhe kontratave për pajisje të TI-së.

Me këtë softuer bëhet gjurmimi zbulimi i të gjitha pasjeve të TI-së në rrjet, duke ruajtur në databazë konfigurimin e pajis-

jeve, kontratën e blerjes së pajisjeve dhe kohën e skadencës së kontratës. Kjo ndihmon në masë të madhe TI-në për menaxhim dhe planifikim të projekteve duke ofruar informata të hollësishme rreth të aseteve të TI-së.

Benefit i këtyre softuerëve është mundësia e gjenerimit të raporteve të ndryshme, të gatshme dhe të kostumizuar, të cilat ofrojnë deri në detale informata rreth sistemeve dhe pajisjeve të TI-së në rrjetin e AKK-së.

Monitorimi

Stafi i TI-së bënë monitorim të vazhdueshëm të infrastrukturës së TI-së në qendrën primare dhe sekondare (DRC). E gjithë infrastruktura e TI-së përmes sistemeve siç janë Solarwinds, vRealize Operations Manager, ADAudit Plus dhe pajisje me sistem të vetin monitorues, monitorohen 24/7 dhe notifikojnë me email stafin e TI-së për ndonjë problem që mund të paraqitet në pajisje\sisitem, tentim për ndonjë veprim të dyshuar që mund të cenoj sigurinë e të dhënave dhe sistemeve kompjuterike dhe kalkulohen trendet e shfrytëzimit të resurseve kompjuterike në qendrat e të dhënave.

Gjatë vitit 2021 kanë dalë nga funksioni

Në Storage VNX 5400 ka dalë nga përdorimi SP/B. Kjo ka shkaktuar që pajisja të ketë vetëm një burim të furnizimit me energji elektrike. Për të eliminuar mundësinë për “downtime” të ndonjë shërbimi të AKK-së, të gjithë serverët përkohësisht janë zhvendosur në STORAGE VNX5300 dhe Unity. Problemi i dështimit të SP/B në këtë storage është zgjidhur duke i bërë modulit “hard reset”. Moduli SP/B është larguar nga Storage dhe është vendosur prapë kështu duke kthyer furnizimin me rrymë edhe në këtë modul. Kanë dalë nga përdorimi 4 disqe në Storage VNX 5300 dhe një disk nga Storage VNX 5400. Disqet

janë zëvendësuar me disqe të reja, të cilat janë porositur më herët si spare parts. Në vitin paraprak njëri nga furnizuesit e rrymës së pajisjes DataDomain kishte dalë nga funksioni. Pas realizimit të procedurave për blerjen e këtij furnizuesit, këtë vit pjesa e ardhur është montuar në DataDomain dhe përsëri është aktivizuar furnizim redundant me rrymë. Po ashtu është rritur hapësira e disqeve, procesorëve dhe RAM memories në server të ndryshëm për të cilët jemi notifikuar se nuk kanë hapësirë të lirë. Në tabelë i gjeni të paraqitura ndryshimet në vlerat e shfrytëzuara, për periudhën 12 mujore të këtij viti, për resurset kompjuterike CPU, RAM dhe Storage në Qendrën e të dhënave të AKK-së:

Resursi kompjuterik	Janar	Dhjetor
CPU	175Ghz	277Ghz
RAM	1.29TB	1.35TB
Storage	96TB	99TB

Tabela 14. Ndryshimet e vlerave hadroerike të shfrytëzuara gjatë vitit 2021

Përveç sistemeve të monitorimit të lartcekura është implementuar edhe monitorimi i webfaqeve nga jashtë (interneti) duke parë se AKK tani më ka disa web faqe publike e të cilat duhet të jenë të qasshme pa ndërprerje pasi që shpeshherë faqet janë të qasshme nga rrjeti i brendshëm mirëpo nga interneti jo. Për këtë është gjetur një softuer online i monitorimit “uptimero-bot.com” i cili mundëson monitorimin e deri 50 faqeve pa pagesë si dhe bënë notifikimin me e-mail nëse ndonjëra nga faqet është jashtë funksionit. Ky softuer monitoron këto web faqe: geopor-tal.rks-gov.net, www.kca-ks.org, kopos.rks-gov.net, siktk-on-line.rks-gov.net dhe akk-statistics.rks-gov.net. web faqet e lart- përmendura monitorohen nëse janë aktive në intervale prej 5 minutash. Pas nxjerrjes së raporteve nga sistemet monitoruese del që për vitin 2021 e gjithë infrastruktura e TI-së ka qenë “UP- TIME” 99.43%, ndërsa të gjitha aplikacionet e

AKK-së kanë qenë të qasshme nga rrjeti i brendshëm 99.91% ndërsa nga rrjeti i jashtëm (interneti) 99.7 %.

Furnizimi me PC

Në Agjencinë Kadastrale të Kosovës që nga viti 2014 nuk janë blerë kompjuter për stafin. Kompjuterët pa kontratë mirëmbajtje dhe në amortizim të plotë, nuk janë teknologji e besueshme dhe nuk garantojnë mbarëvajtje të punës. Këtë viti stafi i TI-së, projektin “Zgjerimi i Qendrës së të dhënave me HW+SW”, e ka ndarë në dy LOT-e. LOT-1 planifikuar dhe përgatitur specifikat për blerjen e 44 kompjuterëve, 8 Lap Topëve dhe 90 monitorë të ri, për gjithë stafin e AKK-së, duke përfshi edhe mirëmbajtje\garancion 5 vjeçar për të siguruar funksionim të plotë të kompjuterëve deri në amortizimin e tyre të plotë. LOT-2, për nevoja të ngritjes së sigurisë në nivel të infrastrukturës së përgjithshme dhe sigurisë së të dhënave, janë përgatitur specifika për aplikacion të monitorimit dhe inventarizimit të pajisjeve TI. Aplikacionet e blera me LOT-2 janë instaluar në një makinë virtuale (server) ku janë konfiguruar dhe aktivizuar politikat e monitorimit. Të dhënat e gjeneruara nga raportet e konfiguruar do të ruhen dhe do të lexohen sipas nevojës. Me LOT-1, deri tani, është realizuar blerja e 24 kompjuterëve dhe 8 Laptopëve. Laptopët janë formatuar, licencuar, u janë instaluar aplikacionet e duhura dhe konfiguruar qasja VPN, dhe u janë shpërndarë zyrtarëve për të cilët kanë qenë të planifikuar të blihen. 24 kompjuterë janë formatuar, licencuar, u janë instaluar aplikacionet e duhura dhe janë bartë shënimet nga kompjuterët e vjetër për secilin punëtor, dhe u janë vendosur kompjuterët e ri në hapësirat e tyre të punës. Për realizimin sa më të mirë të këtij projekti është bërë planifikimi paraprak për mënyrën e shpërndarjes së PC-ve tek zyrtarët, mënyrën e ruajtjes dhe bartjes së shënimeve si dhe planifikim se si të veprohet me kompjuterët e vjetër. Vërejtje: Projekti ka pasur probleme në realizimin e tij të plotë brenda afateve të caktuara kontrak-

tuale, për shkak të vonesave të transportit. Më 30.12.2021 është marrë vendim që të bëhet shkëputja e kontratës me OE “Botek” për shkak të vonesave në liferimin e pajisjeve dhe menjëherë do të vazhdohet me të gjitha procedurat që parashihen në kontratë duke përfshirë edhe padi penale për dëmet e shkaktuara nga mos përmbushja e kësaj kontratë. Gjatë vitit të ardhshëm do të vazhdohet me procedurat e reja të tenderimit për blerjen e pajisjeve të mbetura.

Testimi i ngritjes së shërbimeve në DRC

Drejtorati i TI-së në vitin 2019 ka krijuar dokumentin “Procedurat për Rimëkëmbjen e TI-së në Rast Fatkeqësie”, ky dokument përshkruan procedurat që duhet të ndjekin Administratorët e TI-së së AKK-së për rimëkëmbjen e sistemeve teknologjike në rast fatkeqësive. Përshkruan hapat që duhet ndjekur për testimin e një Plani të rimëkëmbjes, migrimin e planifikuar të serverëve virtual në qendrën sekondare (DRC) si dhe rimëkëmbjen e të gjitha sistemeve kritike nga qendra sekondare në rast të dështimit të qendrës primare. Ky dokument parasheh që këto procedurat të ndjekën dhe testohen çdo 6 muaj, respektivisht në qershor dhe nëntor të çdo viti. Testimi i rregullt 6 mujor është bërë në qershor dhe nëntor të këtij viti, ku janë ngritë shërbimet në qendrën sekondare të të dhënave duke simuluar gjendjen e reale e një “Disaster Recovery”. Përmes SRM është inicuar Disaster Recovery ku virtual makinat e replikuara ngritën në qendrën e dytë në një rrjet virtual të izoluar me qëllim të testimit të funksionimit të kalimit nga qendra e parë në të dytën dhe pa shkaktuar pengesa në ambientin real. Testimi ka dalë të jetë i suksesshëm dhe virtual makinat janë kthyer përsëri në gjendjen normale në qendrën e parë të të dhënave.

Administrimi i Sistemeve të Informacionit (SI), databazave dhe qasjeve

Një prej objektivave të përvitshme dhe mjaft të rëndësishme të DTI-së është edhe administrimi i Sistemeve të Informacioneve (SIKTK-SOA, SUUSK, SIKTK-HK, SIRA, SI-RIK, KOPOS, Intranet, Sistemi i faturimit, Gjeoportali, etj.) në kuptimin e përgatitjeve të ambienteve për testime, trajnime dhe ambienteve reale, sipas kërkesave dhe nevojave. Pjesë e rëndësishme e administrimit të SI është edhe administrimi i databazave, qasjeve, zhvillimi i skripteve TSQL për nxjerrjen e raporteve, statistikave për qëllime të hulumtimit ose të kontrollës së kualitetit të të dhënave kadastrale dhe të tjera, në nivel të databazave. Për aspekte të zhvillimeve të reja dhe mirëmbajtjes së SI (SIKTK-SOA, SUUSK, SIKTK-HK, SIRA, SI-RIK, Gjeoportali), AKK ka angazhuar OE “DataPrognost”, me ekipen e së cilës DTI bashkëpunon në avancimet dhe zhvillimet e reja të Sistemeve të Informacionit.

Statistika, Raporte dhe hulumtime nga databazat kadastrale

Një prej aktiviteteve me konsumim më të lartë të resurseve në DTI në sektorin e Databazës, janë edhe zhvillimet e TSQL skriptave në nivel të databazave (MS SQL Server) për përgatitjen e raporteve dhe statistikave me të dhëna kadastrale sipas nevojave dhe kërkesave. Përveç raporteve dhe statistikave, në nivel të databazave bëhen edhe hulumtime të të dhënave, lëndëve dhe proceseve kadastrale. Aktivitet i përvitshëm është edhe kontrolli i kualitetit të të dhënave si dhe prezantimi i këtyre të gjeturave në funksion të ngritjes së cilësisë së të dhënave dhe shërbimeve kadastrale. Në vazhdim janë listuar këto aktivitete.

- Po ashtu gjatë këtij viti për nevoja të grupit punues të hartimit të termave “Korrektimi i të dhënave në SIKTK-T” janë nxjerr disa statistika nga databaza e SIKTK-T për të shikuar trendin e përmirësimit të të dhënave personale

të pronareve nga ana e zyrave kadastrale komunale, këto statistika përfshijnë llojet e lëndëve : “Modifikimi i të dhënave për personin”, “Modifikimi i të dhënave të personit pa njësi kadastrale”, “Bashkimi i personave të njëjtë me ID të ndryshme”, Bashkimi i personave të njëjtë me ID të ndryshme pa njësi” për periudhën nga viti 2018-2021. Po ashtu edhe statistika për të shikuar gjendjen momentale të të dhënave të pronareve që përfshijnë : Numri total i pronarëve në SIKTK-T, Numri total i pronarëve me KCID ID, Numri total i pronareve me KCID ID që s’kanë pas asnjë transaksion në të dhënat e pronarit. Për këtë projekt janë përgatitë të dhëna për disa lloje të gabimeve në të dhëna: Numri identifikues “KCID”, Të dhënat e personave që përmbajnë karaktere tjera përveç shkronjave dhe numrave tek numri personal, Persona juridik të regjistruar me tipin person fizik, Persona me llojin e ID “i Panjohur”, Pronarë pa numër personal, Pronarë me ID kode me më shumë se një herë. Po ashtu për këtë projekt janë përgatitë statistika për numrin e pronareve me ID personale ‘KCID’ për çdo Komunë të Kosovës duke përfshirë tërësinë e zonave kadastrale të cilat kanë me qenë pjesë e Rindërtimit të informacioneve kadastrale gjatë viteve në vijim.

- DTI gjatë këtij viti ka përgatitë të dhëna tekstuale kadastrale për njësi dhe pronarë nga databaza e SIKTK-T dhe SIKTK Online për disa institucione si : Zyrën e Kryeministrit, Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Komuna E Obiliqit, Komuna e Drenasit, Komuna e Mitrovicës, Komuna e Prishtinës, Mitrovicës Veriore, Komuna Zveçan, Komuna Podujevës, Komuna Vushtrrisë, Komuna e Lipjanit, Instituti për Bujqësi, FSK, Policia e Kosovës, Trepça SH.A, Institucionet Mikrofinanciare, Bankat komerciale, Departamenti i Tatimit në Pronë, Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Gjykatës themelore në Pejë, Departamentin e Shpronësimit, Min-

istria e Bujqësisë

- Me kërkesë të DK për një kohë janë përcjell dhe njëkohësisht janë krijuar raporte për regjistrimin, modifikim dhe fshirjen e hipotekave të cilat janë regjistruar përmes modulit online të Bankave për Komunën e Graçanicës. Të gjitha këto të dhëna janë përgatitë nga databaza e SIKTK Online. Llojet e raporteve të përgatitura përgatit janë: Numri hipotekave të aprovuara, refuzuara , të pashqyrtuara (pa aktvendim), të shqyrtuara (me aktvendim), të pa shqyrtuara fare nga ZK (pa komente nga ZK) në SIKTK-T përmes modulit online të bankave të ndarë sipas llojit Regjistrim/Modifikim/Fshirje.
- Statistika tjera të kërkuara janë: Numri i regjistrimeve të hipotekave, Numri i transaksioneve (Numri i lëndëve të aprovuara në SIKTK-T nga të gjitha ZKK) në SIKTK-T, Numri i regjistrimit të Ndërtesave, Numri i regjistrimit të Pjesëve të Ndërtesave. Të gjitha këto për periudhën nga 1 Janari deri në Dhjetor 2021.Po ashtu edhe për Totalin e parcelave: Totali i parcelave me format të rregullt, parregullt si dhe totali i parcelave me komasacion, të gjitha këto janë nxjerr për çdo Komunë. Titullarët e pronave për tërë Kosovën ku tipin e pronës e kanë NULL/Private/Shoqëror/Shtetëror', numrin e pronarëve të rijnë të ndarë sipas gjinisë për vitin 2021, nxjerrja e numrit të pronarëve me KCID ID nga viti 2018 -2021 për çdo komunë dhe zonë kadastrale ,është bërë edhe nxjerrja e numrit total të lëndëve të aprovuar në KCLIS-T nga 2018-2021 si dhe numri total i lëndëve të aprovuara ku në mesin e pronarëve ka me KCID ID person.
- Është bërë unifikimi i emrave të të gjitha zonave kadastrale të Kosovës nga grupi punues. Në databazën e sistemit CadastralMap janë azhurnuar emrat e të gjitha zonave kadastrale në tri gjuhe : Shqip, Anglisht dhe Turqisht duke u bazuar në listën finale me Emrat e Unifikuar
- Në data bazën e Cadastral Map-it real janë përmirësuar

emrat e zonës kadastrale Kremenatë I dhe Kremenatë II nga Komuna e Kamenices dhe emrat e zones kadastrale Potoçan i Epërm dhe Potoçan i Poshtëm nga Komuna Rahovec-it

- Në databazën Kclis-T është azhurnuar emri i Zonës Kadastrale Muhaxheri i Epërme (70202020) në Studime e Epërme të Komunës Vushtrri dhe ne Komunën Skënderaj është azhurnuar emri i Zonës kadastrale Obri e Poshtme (72015026) ne Abri e Poshtme .
- Është analizuar data baza KosovoCadastreDatabase e aplikacionit Cadastral Map e posaçërisht tabela Kosovo-CadastreSchema.ParcelDetail. Kjo analizë është bërë për arsye se te disa parcela sipërfaqja figuron NULL në data bazë , e nëse e kërkon po të njëjtën parcelë në aplikacion figuron sipërfaqja .Në bazë të disa kërtimeve dhe analizave është gjet se sipërfaqja nuk ruhet vetëm te kolona Area por edhe në kolonën Geometry. Kështu që është krijuar query për gjetjen e sipërfaqes së njësive kadastrale aktive për komunë së bashku me zonat kadastrale në databazën KosovoCadastreDatabase.

Të gjitha këto statistika janë kërkuar dhe kanë kaluar përmes njërës nga këto zyre : Zyrës së Kryeshefit të AKK-së, Zyrës së Marketingut të AKK-së, Drejtoratit të Kadastrit pranë AKK-së ose zyrës për implementimin e projektit të Bankës Botërore

Parcelat-Krahasimi SIKTK-T dhe SIKTK-HK

SIKTK-HK: 38 Komuna, 1304 zona kadastrale

Total Parcela Aktive në SIKTK-T: 2,180,823

Total Parcela Aktive në SIKTK-HK: 2,061,696

Totali i parcelave aktive që janë në SIKTK-T e jo në SIKTK-HK: 253,796

Totali i parcelave aktive që janë në SIKTK-HK e jo në SIKTK-T: 129,049

Parcelat aktive të përbashkëta që janë në SIKTK-T dhe SIKTK-HK është: 1,925,820
--

Tabela 15. Krahاسimi i parcelave në SIKTK-T dhe SIKTK-HK

22. GJITHPËRFSHIRJA SHOQËRORE

22.1 GRUAJA DHE PRONA

AKK parasheh përfshirjen sa më të madhe dhe sa më aktive të qytetarëve gjatë implementimit të projekteve të saja, me qëllim që të njëjtit të jenë përfitues nga aktivitetet, produktet dhe shërbimet kadastrale dhe gjeohapësinore dhe të jenë pjesëmarrës në tregun e pronave dhe përfitues nga zhvillimi i tij. Kjo për shkak se të drejtat pronësore luajnë një rol të madh edhe në avancimin e mirëqenies së qytetarëve si përmes shitblerjes së pronave po ashtu edhe përmes hipotekimit për nevoja të kredi marrjes. Po ashtu, AKK rëndësi të veçantë u kushton përfshirjes së grupeve potencialisht të marginalizuara në të drejta pronësore, me theks të veçantë gratë dhe komunitetet pakicë. AKK ka implementuar projekte të ndryshme për avancimin e të drejtës së gruas në pronë. Për këtë arsye dhe me qëllim të informimit të ndërsjellët rreth aktiviteteve të institucioneve respektive dhe për të identifikuar fushat e interesit të përbashkët ku ky bashkëpunim do të mund të intensifikohej, zv. Drejtoresha e Përgjithshme e Agjencisë Kadastrale të Kosovës z-nja Afërdita Thaçi ka mbajtur një takim pune me Kryeshefen e Agjencisë për Barazi Gjinore z-njën Edi Gusia. Fokus i këtij takimi ishte avancimi i të drejtave të gruas në përgjithësi si dhe përfshirja e gruas në shfrytëzim të të drejtave pronësore në veçanti. Po ashtu, si rekomandim i përbashkët nga ky takim doli edhe propozimi rreth masës afirmative për regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve pa pagesë, respektivisht u propo-

zua që kjo masë afirmative mos të jetë e përkohshme por e njëjta të rregullohet me Udhëzim Administrativ të përhershëm, sidomos nëse merret parasysh ndikimi që e njëjta ka pasur në ngritjen e numrit të pronave të regjistruara në emër të të dy bashkëshortëve. Po ashtu, në takim u propozua një bashkëpunim më i avancuar në faza të ndryshme të implementimit të Projektit për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme në Kadastër dhe për Infrastrukturë Gjeohapësinore, huamarrje kjo nga Banka Botërore e në kuadër të së cilit projekt parashihet implementimi i dhjetëra aktiviteteve nga të cilat përfituese mund të jenë edhe gratë. Përndryshe statistikën pronësore në baza gjinore dhe të tjera janë si në vijim:

Statistikat e pronarëve në bazë gjinore në nivel vendi janë 457,383 (79.7%) meshkuj dhe 105,662 (18.41%) femra;

Numri i pronave të regjistruara në emër të pronarëve – personave juridik është: 10,824(1.9%)

Tabela në vijim paraqet trendet e regjistrimit të pronave në emër të dy bashkëshortëve si bashkëpronar nëpër vite, nga hyrja e Udhëzimit Administrativ e deri më tani:

Viti	Numri i grave që kanë fituar të drejtën "Pronësi / Posedim i Përbashkët"	Numri i njësive kadastrale që kanë fituar të drejtën Pronësi / Posedim i përbashkët
2016	533	834
2017	804	1190
2018	1138	1560
2019	1533	2195
2020	1641	2392
2021	3202	4924

Tabela 16. Numri i grave dhe parcelave që kanë fituar të drejtën "Pronësi / Posedim i Përbashkët".

22.2 KOMUNITETET DHE QASJA E TYRE NË PRONË

Në kuadër të Projektit për Regjistrimin e Pronës në Kadastër dhe për Infrastrukturë Gjeohapësinore është ndarë buxhet edhe për investime kapitale në Komunën e Zubin Potokut, Leposaviqit dhe Zveqanit por me kusht që paraprakisht në këto Komuna të funksionalizohen Zyrat Kadastrale Komunale. Edhe pse AKK, si rezultat i marrëveshjes së Brukselit ka të punësuar dhe trajnuar 6 persona për kryerjen e shërbimeve kadastrale në këto komuna, të njejtit deri më sot nuk kanë pasur angazhim për arsye politike. Si pasojë, qytetarët e atyre Komunave nuk po mund të pajisen me dokumente zyrtare pronësore të Republikës së Kosovës ndërsa për të shmangur një gjë të tillë, AKK ka marrë përsipër pajisjen e këtyre qytetarëve me dokumente pronësore të Republikës së Kosovës. Pos komunitetit serb në të këtyre tre Komunave, në kuadër të projektit REGIP do të aspirohet edhe përfshirja e komunitetit RAE. Për këtë arsye, një ekip i Bankës Botërore ka zhvilluar një vizitë pune në Komunën e Gjakovës ku kanë mbajtur takime me Femrat Aktive të Gjakovës, një organizatë e shoqërisë civile me të cilën ekipi ishte partner në prill-maj 2021 për të hetuar sfidat me të cilat përballen komunitetet RAE lidhur me regjistrimin e pronës së tyre.



